



USHTRIA



Viti i 69-të i botimit Nr. 5 (8256)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 6 shkurt 2015

“MBËSHTETJE E PALËKUNDUR E SHQIPËRISË NDAJ TË GJITHA KËRKESAVE TË NATO-S”



5 shkurt 2015

Ministrja e Mbrojtjes, Znj. Mimi Kodheli, mori pjesë në takim të ministerialit të zhvilluar sot në Bruksel. Ky ishte takimi i parë i Ministrave të Mbrojtjes së vendeve aleate, që pas Samitit të Uellsit, në shtatorin e vitit të kaluar. Takimi u hap me diskutimet rreth vendimeve të marra në Uells dhe me shikimin drejt Samitit të Varshavës në 2016, për t'u fokusuar më tutje me planet e veprimit për gadishmërinë.

Një çështje e rëndësishme që u diskutua ishte komisioni NATO-Gjeorgji, ku i pranishëm ishte edhe Ministri gjeorgjian i Mbrojtjes. Gjate këtij sesioni u diskutua mbi kontributin e madh që po jep aktualisht Gjeorgjia në “Resolute Support Mission” në Afganistan, si kontribuesi i dytë më i madh jo aleat. Shqipëria u angazhua se do të jetë e pranishme në misionin e NATO-s në Gjeorgji...

» faqe 2

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli: Guxoni të projektoni të ardhmen tuaj

Projektet më të mira do bëhen realitet

» faqe 6

“JUGU-2015”

Forcat e Armatosura, angazhim maksimal në operacione të evakuimit dhe shpëtimit

Kontributi i FA me forca dhe mjete të shumta në zonat e prekura nga përmbytjet



» faqe 3-5



Konferenca

Rritja e bashkëpunimit në fushën e sigurisë detare

Në Komandën e Forcës Detare, më 29 janar 2015 u zhvillua konferenca e parë planëzuese e stërvitjes rajonale “Adriion – Livex - 2015”. Në këtë konferencë morën pjesë kuadro drejtues dhe organizues të kësaj stërvitjeje nga vendet pjesëmarrëse...

» faqe 6



QKMBMMSHP

Koncert mbresëlënës “Ta duam më shumë Shqipërinë”

Ditën e shtunë (31 janar 2015) në QKMBMMSHP u zhvillua një koncert i veçantë nga fëmijët e ushtarakëve dhe punonjësit të Ministrisë së Mbrojtjes. Një koncert me këngë, recitime dhe interpretime në kitarë nga fëmijë të...

» faqe 12



AKADEMIA USHTARAKE MBRETËRORE E SANDHURST

Një oficer shqiptar në Sandhurst

“Në historikun 200 vjeçar të Sandhurst mes të diplomuarve të famshëm të oborreve mbretërore janë edhe 2 oficer shqiptarë”

» faqe 8

NATO

Aleanca i përshtatet mjedisit të ndryshuar të sigurisë

faqe 10-11

ANALIZA

Afganistani, e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja

faqe 15

Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli merr pjesë në Ministerialin e NATO-s në Bruksel

"Mbështetje e palëkundur e Shqipërisë ndaj të gjitha kërkesave të NATO-s"

TAKIMI

Një çështje e rëndësishme që u diskutua ishte komisioni NATO-Gjeorgji, ku i pranishëm ishte edhe Ministri gjeorgjian i Mbrojtjes. Gjate këtij sesioni u diskutua mbi kontributin e madh që po jep aktualisht Gjeorgjia në "Resolute Support Mission" në Afganistan, si kontribuesi i dytë më i madh jo aleat. Shqipëria u angazhua se do të jetë e pranishme në misionin e NATO-s në Gjeorgji.



5 shkurt 2015

Ministrja e Mbrojtjes, Znj. Mimi Kodheli, mori pjesë në takimin e ministerialit të zhvilluar sot në Bruksel. Ky ishte takimi i parë i Ministrave të Mbrojtjes së vendeve aleate, që pas Samitit të Uellsit, në shtatorin e vitit të kaluar. Takimi u hap me diskutimet rreth vendimeve të marra në Uells dhe me shikimin drejt Samitit të Varshavës në 2016, për t'u fokusuar më tutje me planet e veprimit për gadishmërinë.

Një çështje e rëndësishme që u diskutua ishte komisioni NATO-Gjeorgji, ku i pranishëm ishte edhe Ministri gjeorgjian i Mbrojtjes. Gjate këtij sesioni u diskutua mbi kontributin e madh që po jep aktualisht Gjeorgjia në "Resolute Support Mission" në Afganistan, si kontribuesi i dytë më i madh jo aleat. Shqipëria u angazhua se do të jetë e pranishme në misionin e NATO-s në Gjeorgji.

Gjendja e krijuar në lindje dhe jug të kufijve të Aleancës, ishte tema tjetër e diskutimeve gjatë këtij ministeriali. Zhvillimet politiko-ushtarake në Rusi dhe Lindjen e Mesme kërcënojnë në mënyrë të vazhdueshme sigurinë e vendeve aleate. Si rrjedhojë përforsimi i masave të marra gjatë Samitit të Uellsit është e vetmja përgjigje e NATO-s.

Ministrja e Mbrojtjes znj. Kodheli, në fjalën e saj, rikonfirmoi mbështetjen e palëkundur dhe të menjëhershme të Shqipërisë ndaj të gjitha kërkesave të NATO-s. Ne jemi këtu për t'u përgjigjur vendimarrjeve Politiko-Ushtarake të Aleancës. Ajo siguroi që Shqipëria po ndërmerr hapa të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve operative të Forcave të Armatosura për të rritur aftësinë për t'u përgjigjur situatave të ndryshme dhe për t'i ardhur në ndihmë Aleancës. Gjithashtu, bëri të sigurt që, Shqipëria i njeh Ukrainës dhe Gjeorgjisë kufinj të qw njeh NATO dhe OKB.

Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli merr pjesë në Ministerialin e NATO-s në Bruksel

Kodheli: Jemi këtu për t'ju përgjigjur çdo vendimarrjeje politike dhe ushtarake që kërkon Aleanca

5 shkurt 2015

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli ndodhet në Bruksel, ku po merr pjesë në takimin e Ministrave të Mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s.

Ministrja Kodheli, pas takimit u shpreh: "Ne jemi këtu për t'ju përgjigjur pozitivisht kërkesave të NATO-s. Ne i njohim Ukrainës dhe Gjeorgjisë kufijtë që i njeh NATO dhe OKB. Jemi këtu për t'ju përgjigjur çdo vendimarrjeje politike dhe ushtarake që kërkon Aleanca".

Ky është takimi i parë pas Samitit të Uellsit të mbajtur në shtator të vitit të kaluar. Ky Ministerial mbahet për të parë progresin që është bërë pas Samitit të Uellsit dhe për t'i paraprirë Samitit të radhës në Varshavë në vitin 2016. Fokusi kryesor i këtij takimi ishte Plani i Veprimit të Gatishtëm të miratuar në Samitin e Uellsit të NATO-s vitin e kaluar. Gjithashtu u zhvillua një takim të grupit të planifikimit bërthamor, i cili është një takim i rregullt që ministrat zhvillojnë çdo vit. Takimi vijoi me një takim të komisionit NATO-Gjeorgji, me Ministrin e Mbrojtjes së Gjeorgjisë. Gjithashtu ministrat e Mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s diskutuan mbi zhvillimet në Siri dhe kërcënimin nga i ashtuquajturit shteti Islamik ISIS, kërcënimin me të cilin po përballohet Aleanca në kufinj të saj Jugorë dhe Juglindorë si dhe ndikimi i tyre në procesin e Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s.

Znj. Ministre çfarë u diskutua sot në Ministerialin e NATO-s dhe çfarë roli ka Shqipëria në sfidën e NATO-s sa i përket çështjes së Ukrainës?

Tju them të drejtën kemi shpenzuar vetëm gjysmën e diskutimeve ashtu siç edhe ju e thatë është një shqetësim i madh për vendet anëtare të NATO-s. Shqetësimi vjen për shkak të kërcënimit që i vjen europës, kufijve NATO nga lindja dhe Juglindja. Padyshim kjo ishte tema kryesore e diskutimit. Sot ne bëme një mbledhje të përbashkët NATO-Gjeorgji sepse gjeorgjia ka të njëjtat probleme përballet me të njëjtat probleme duke qenë një vend kufitarë me fedderatën ruse. Sigurisht rritet intensiteti i punës në raport me këtë çështje, rritet mënyra sesi kufijtë NATO do të mbrohen ktej e tutje, rritet kërkesat NATO ndaj të gjithë aleatëve dhe partnerëve. Ne jemi këtu për t'ju përgjigjur pozitivisht të gjithë kërkesave të tyre, do të vazhdojmë të mbetemi po aq të fortë në vendimarrjen tonë dhe në të njëjtën përfaqje që kemi pasur. Ne i njohim Ukrainës kufijtë që njeh NATO, kufijtë që njeh OKB-ja, ne i njohim Gjeorgjisë kufijtë që NATO njeh, kufijtë që OKB-ja njeh. Ne nuk jemi për sulme të kësaj natyre në mënyrë absolute, por jemi për bashkëbisedim për aq sa partneri që kemi përball do të na e lejonte këtë gjë, por padyshim jemi këtu edhe për t'ju përgjigjur nga pikpamja politike dhe ushtarake çdo kërcënim që vjen në kufijtë lindorë tanë.

Znj. Kodheli për t'u zhvendosur pak edhe në situatën politike në Shqipëri pas rastit të përfshirjes së një majori Shqiptarë në atë që konsiderohet deri tani një trafik ndërkombëtarë droge. A ka ndërmend ministria juaj të marrë masa konkrete, ndoshta njëforcim ligjorë, apo dhe ndaj autoriteteve të cilat ndoshta duhet ta kishin kontrolluar lëvizjen e majorit Feka. Cilat janë lëvizjet e ministrisë?

Atëherë unë ju them se ky është një proces në vazhdim. Është një proces që ka filluar një vit më parë dhe do vazhdojë të forcohet si i tillë. Për çfarë procesi flas? Flas për procesin e betimit të të gjithë Forcave të Armatosura, i cili jo domozdoshmërisht është bërë ashtu siç duhet në të shkuarën. Flas për një tjetër mënyrë përfaqesjeje për mënyrën sesi ushtarakët marin leje, sesi duhet



të respektojnë disiplinën, sesi duhet të respektojnë statusin e ushtarakut e kështu me radhë. Rasti Feka është një rast që më ka bërë pa as më të voglin dyshim të ridimensionojmë të gjithë rregulloret mbi të cilat funksionin FA. Pa

asmë të voglin dyshim ne kemi filluar investigimin e menjëhershëm të implikimit që mund të kishte majori me kolegë të tjerë. Unë i kam kërkuar javën që shkoi Prokurorisë së Përgjithshme, kryeprokurorit Llalla të hapë procesin dhe po ashtu kam bërë një kërkesë dje përpara largimit tim për ardhjen në Bruksel, një tjetër kërkesë për t'u involvuar në të gjithë investigimin që Policia Ushtarake, që Shërbimi Informativ Ushtarak është duke bërë lidhur me këtë detaj. I kam kërkuar edhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda të implikohet dhe involvohet në një proces, i cili duhet ta nxjerr ashtu siç dhe është Forcën e Armatosur të pastër nga një rast si ky. Më ejonit të ndaj me ju dhe me publikun shqiptarë, rastë të tilla brenda FA të SHBA apo brenda FA të çdo shteti tjetër vend anëtarë i NATO-s mund të ketë dhe ka, e rëndësishme është respektimi i ligjit, e rëndësishme është respektimi i procedurave. Lidhur me largimet që Ministria e Mbrojtjes ka bërë me propozim të Shtabit të Përgjithshëm të disa funksionarë ve të lartë të FA, qoftë të kolonel Demirajt, qoftë të një piloti tjetër, kolonel Çunajt e kështu me radhë. Duhet të dini që një arsye pse këtë zotërij janë larguar nga FA, është pikërisht mosmarja e lejes në daljet e tyre jashtë, pra për aq kohë sa është thyer disiplina, për aq kohë sa nuk është respektuar ligji i statusit për ushtarakun, kjo është një histori që nuk duhet as të përsëritet, as të konsiderohet si diçka politike, apo si diçka që nuk ka të bëjë me disiplinën e FA, përkundrazi fakti që deri dje në qeverinë e mëparshme nuk është marë asnjë herë leje për të dalë jashtë, nuk ka pasur një procedurë të mirëfilltë, për të mos folur për investime se ku do të shkosh jashtë dhe pse shkon jashtë, na ka sjellë në rezultate dhe konkluzionin që disiplina duhet forcuar ashtu siç dhe po bëhet. Çështja është nën investigim, unë besoj shumë në atë çka FA bëjnë, rrespektimin e disiplinës dhe përbushjen e misionit të tyre sa fisnik aq dhe kushtetues që është mbrojtja jo vetëm e integritetit të Republikës së Shqipërisë, por pa as më të voglin dyshim ashtu siç dhe ky ministerial e demonstron të qenit prezent bashkë me aleatët kudo ku rrishtu i demokracive është në rrezik.

Javën tjetër do jeni në interpelancë?

Në qoftë që më kërkohet nga opozita pa as më të voglin dyshim nuk kam asnjë problem t'i përgjigjem gjithkujt për gjithçka FA, ministria ka bërë dhe do të vazhdojë të bëjë në këtë drejtim.

Vazhdon angazhimi i Forcave të Armatosura për përballimin e situatës së krijuar nga përmbytjet

FA në gatishmëri të plotë për përballimin e situatës së krijuar nga përmbytjet

Operacioni i FA në ndihmë të popullsisë së përmbytur në Jug të vendit

E mërkurë, 04 shkurt 2015, Forcat e Armatosura vijojnë të japin kontributin e tyre me forca dhe mjete të shumta në zonat e prekura nga përmbytjet, kryesisht në jug të vendit, ku dhe situata paraqitet më e rënduar.

Gjatë ditës së mërkurë, 17 efektivë dhe 4 mjete të Komandës së Mbështetjes punuan për largimin e ujërave që rrezikonin rezervuarin e Maskurës në Golem, Kavajë.

Gjithashtu po nga efektivët e kësaj komande u angazhuan 19 vetë dhe 6 mjete në Novoselë, Vlorë, për transport ndihmash ushqimore. Gjithashtu, dy mjete të tjera u vunë në dispozicion të Prefekturës së Fierit për të qenë të gatshme për operacionin e shpëtimit dhe të evakuimit në rast se paraqitet nevoja.

Ndërsa Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes gjatë datës 04 shkurt ka angazhuar për transport ndihmash në Komunën e Novoselës 15 efektivë dhe 4 mjete.

Në Qarkun e Beratit 20 forca dhe 2 mjete ishin në gjendje gatishmërie për çdo situatë dhe nevojë që do të kishte Shtabi i Emergjencave në këtë qark.

Në total gjatë ditës së mërkurë në aksionin e emergjencave për përballimin e situatës së rënduar nga përmbytjet u angazhuan 83 trupa, 18 mjete, 4 motopompa, 2 motobarka dhe 4 gomone.

Forcat e Armatosura janë në gatishmëri të plotë me trupa dhe mjete për t'i ardhur në ndihmë banorëve të prekur nga përmbytjet.

E martë, 03 shkurt 2015, Forcat e Armatosura, me kërkesë të prefekturave të qarqeve të Jugut dhe me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, u angazhuan në ndihmë të popullsisë së përmbytur në jug të vendit, përkatësisht:

Komanda e Mbështetjes, u angazhua në operacion evakuimi:

a. Në Komunën Novoselë, Vlorë me 20 forca dhe 3 mjete transporti, 2 motobarka, 4 gomone të batalionit të kërkim - shpëtimit. U evakuuan 5 persona dhe u shpërndanë ndihma për banorët në nevojë.

b. Në Komunën Levan, Fier, me 2 automjete të kalueshmërisë së lartë, në mbështetje të Shtabit të Emergjencave Civile të Qarkut Fier, për evakuim popullsisë si dhe transport të forcave të rendit për në fshatin Hoxharë.

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, u angazhua në operacion evakuimi:

a. Në komunën Novoselë, Vlorë, me 10 forca dhe 4 mjete transporti të QSI, Bunavi, në mbështetje të Shtabit të Emergjencave Civile të Qarkut Vlorë, u evakuuan 35 persona, 2 mjete civile dhe u shpërndanë ushqime për familjet në nevojë.

Totali i forcave dhe mjeteve të Forcave të Armatosura të angazhuara në operacion: Forca: 232 persona.

Mjete transporti: 29 copë.

Mjete transporti ujor: 2 motobarka, 4 gomone.

Gjithashtu, Forcat e Armatosura kanë në gatishmëri operacionale të gjitha kapacitetet e deklaruar për përballimin e Emergjencave Civile.

Për shkak të vijimit të kushteve të këqija të motit, angazhimi i Forcave të Armatosura në operacione për përballimin e situatës së krijuar në Jug të vendit për shkak të reshjeve të dendura të shiut, vijon me të njëjtin intensitet dhe me të njëjtin përkushtim.

E hënë, 02 shkurt 2015, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë bazuar në kërkesat e Prefekturës së Vlorës, Beratit, Gjirokastrës, Fierit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, janë të angazhuara në ndihmë të popullsisë së përmbytur në rajonet jugore të vendit. Në fshatin Novoselë, Vlorë, FA janë të pranishëm me trupa dhe automjete transporti. Forcat e Armatosura kanë kryer evakuimin e personave, Ura Vajgurore: 12 familje me 15 persona, Poro, Vlorë: 118 persona dhe disa automjete civile, Akërnë, Novoselë: 3 familje me 27 persona, dhe Fitore, Novoselë: 6 familje me 25 persona. Gjithësej të evakuuar 222 persona dhe disa mjete civile.

Operacion zhblokim rrugësh nacionale:



- Zhblokim i rrugës nacionale Gjirokastrë - Kakavijë
- Riparim ure në qytetin e Përmetit
- Transport ndihmash ushqimore në fshatin Novoselë
- Transport i forcave të rendit në fshatrat Hoxharë dhe Levan, Fier.

Krahas operacioneve të evakuimit dhe zh-

bllokimit të rrugëve, Forcat e Armatosura gjatë ditës së sotme janë angazhuar edhe në shpërndarjen e ndihmave ushqimore për familjet në nevojë.

Forcat e Armatosura vijojnë të jenë të gatishmëri totale me kapacitete njerëzore mbi 250 në terren me mjete transporti 30 copë, mjete ajrore: 1 helikopter, mjete



transporti ujor, motobarka dhe gomone. **E dielë, 01 shkurt 2015,** Si pasojë e reshjeve të fundit që kanë rënë në vendin tonë, Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura janë angazhuar në përballimin e situatës së krijuar, kryesisht në jug të vendit.

Trupa të shumta dhe mjete të Forcave të

Armatosura po vijonë punën në terren pa u ndalur prej disa orësh për eliminimin e pasojave të shkaktuara nga reshjet dhe për përballimin e situatës së krijuar.

Për përballimin e situatës së krijuar nga përmbytjet e shumta, në dispozicion të operacionit të emergjencave është venë edhe Forca Ajrore.

Në qytetin e Memaliajt, ditën e dielë më 1 shkurt 2015, Forca Ajrore bëri të mundur evakuimin me helikopter të shtetasit, Fatos Vranoci, i cili kishte mbetur i bllokuar nga vërshimi i madh i ujërave, në çatinë e lokalit të tij. Gjatë ditës së sotme efektivët e FA në Qarkun e Beratit bënë të mundur evakuimin e 9 familjeve, të cilët kishin mbetur të izoluar për shkak të përmbytjeve.

Gjithashtu Forcat e Armatosura janë në gatishmëri edhe në qytetin e Vlorës me trupa dhe mjete për t'i ardhur në ndihmë qytetarëve të bllokuar nga reshjet dhe vërshimet e ujërave.

Ndërkohë drejtuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura po ndjekin situatën e krijuar nga përmbytjet, në Qendrën e Bashkuar Operacionale.

Efektivat e Forcës Tokësore në mbështetje të Emergjencave Civile

Profesionalizëm dhe ndjenjë e lartë përgjegjësie

Trupat e batalionit të tretë të këmbësorisë Poshnjë, Berat realizojnë evakuimin e 50 personave të bllokuar në zonat e përmbytura

"Jemi krenarë që kemi vënë në provë me sukses të gjitha strukturat dhe strukturat janë përgjigjur në kohë detyrave të tyre." -kështu u shpreh kryeministri Rama gjatë inspektimit që bëri në zonën e përmbytur në Urën Vajgurore dhe Berat.

Situata e rënduar e motit gjatë ditëve të fundit, bëri që vërshimi i rrëmbyshëm i lumenjve, Devoll dhe Osum, të vënë në rrezik jetën e banorëve të dy lagjeve të Bashkisë Urë Vajgurore, fshatit Qëndër Tapi në Komunën Perondi, Kuçovë.

Nisur nga kjo situatë, në orën 07:00, të datës 01.02.2015, efektivit i batalionit të tretë të këmbësorisë, garnizoni Poshnje Berat, filloi operacionin për evakuimin e popullsisë civile. Ky operacion përfundoi në orën 21:30 të datës 01.02.2015, ku përveç personelit prej 30 vetësh (oficerë, nënoficerë dhe Upr), u angazhuan edhe 3 automjete dhe një varkë pa motor. Mjetet e lundrimi si dhe pajisjet që disponon ky batalion, u bënë një nga faktorët kryesorë për realizimin me sukses të këtij operacioni. Nga personeli i b3k-së, u krye evakuimi i 12 familjeve të bllokuara nga uji. Numri u personave të evakuuar arriti në 50 vetë, kryesisht gra, të moshuar dhe fëmijë. Në Lagjen "Fusha e sportit" në Bashkinë Ura Vajgurore, u bë evakuimi dhe transporti me ambulancë për në spitalin rajonal Berat, i një gruaje, e cila kishte probleme shëndetësore. Në fshatin Qëndër Tapi, në orët e mbrëmjes, në kushtet e pamjes së kufizuar, u bë evakuimi, i dy familjeve, të cilat kishin mbetur të izoluar nga ujrat.

Ky operacion u drejtua me kom-



petencë në çdo minutë të zhvillimit të tij, nga komandanti i këtij reparti n/ kolonel Gëzim Marku, i cili gjatë gjithë kohës duke mbajtur lidhje të ngushta me shtabin qendror të emergjencave civile, dhe duke njohur situatën bëri të mundur përballimin e të gjitha situatave të vështira të krijuara nga shiu i rrëmbyer. "Trupat e batalionit të tretë të këmbësorisë në plotësim të misionit të tyre kushtetues në raste të tilla, japin ndihmën e tyre në shërbim të popullsisë civile, kjo gjë e vlerësohet edhe në ditët e sotme ku duke parë situatën meteorologjike që po rëndohej morëmasat tona për t'iu përgjigjur në kohë reale nevojave të popullsisë", - tha n/ kolonel Marku. "Kemi dalë që në orët e para të mëngjesit dhe po përballemi me këtë situatë. Dua të falenderoj efektivin e batalionit për përkushtimin në dhënie

e ndihmës këtyre familjeve të bllokuara nga uji. Jemi në ndjekje të situatës dhe nëse do të jetë nevoja do të qendrojmë këtu për mos të lënë asnjë jetë njerëzish të rrezikohet." - tha ai në përfundim të këtij operacioni.

Gjatë kryerjes së operacionit të evakuimit u bashkëpunua ngushtë, me të gjitha strukturat e Emergjencave Civile të Qarkut Berat. I gjithë personeli pjesmarës në operacion tregoi profesionalizëm dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie gjatë kryerjes së kësaj detyre dhe u vlerësua maksimalisht nga popullata në zonën e operacionit.

Puna vetëmohuese e këtyre trupave nuk ngeli pa u falenderuar edhe nga kryetari i Bashkisë së Urës Vajgurore, Syrja Ormeni i cili vlerëson profesionalizmin dhe shpejtësinë e reagimit të tyre në këtë situatë emergjente. "me këta djem heronj

mund të them se nuk ka asgjë, as moti i keq, dhe as ujërat e rrëmbyera që mund të na trembin. Falë ndihmës së tyre arritëm që shumë familje t'i nxjerrim nga zonat e përmbytura, falë tyre asnjë nga nënat tona nuk u përlot." - u shpreh kryetari i Bashkisë së Urës Vajgurore.

Situata e rënduar e motit, nga rreshjet e shiut të ditëve të fundit, evidentoi edhe një herë profesionalizmin dhe shpirtin e sakrificës së efektivit të b3k. Nuk mund të lemë pa përmendur togerin Sarandi Berberi i cili në krye të togës së gatshme u bë shembull për efektivin e tij. Nëntetarët Renato Nano dhe Eugert Hasani me ishin të parët që u futën me varkën e tyre në ujërat e rrëmbyera të lumit Osum për të shpëtuar familjet e rrezikuara.

Pesha e barrelës që mbanin mbi supet e tyre, shiu i dendur dhe era e furishme, për ushtarët Arban Xhaferrri, Mirsad Shani, Mateus Oboni, nuk ishte asgjë para jetës që ata po përpiqeshin të shpëtonin. Falë shpejtësisë dhe profesionalizmit të tyre u bë e mundur që i sëmurit që mbanin mbi supet të dërgohej në spital duke i shpëtuar jetën.

Po kështu forcat e batalionit me ndihmën e tyre bënë të mundur që së bashku me trupat zjarrfikëse të Qarkut Berat, të pastrojnë shtëpitë nga balta e ngelur nga përmbytja. Këtë gjë e vlerësoi edhe drejtori i Emergjencave Civile.

Edhe gjatë ditëve në vazhdim, këto forca po qendrojnë në gadishmëri për t'iu përgjigjur situatave emergjente.

**Nënkolonel Edian ELEZI
Kapiten Ervin HODO**

OPERACIONI "JUGU-2015"

Forcat e Armatosura, angazhim maksimal në operacione të evakuimit dhe shpëtimit

Pak histori për përmbytjet

Pellgu hidrik i Shqipërisë përfshin një sipërfaqe prej 43.305 km², prej të cilave 14.557 km² që u përkasin pellgjeve ujëmbledhës të lumenjve Drini e Vjosa, janë brenda territoreve të Greqisë, Kosovës e Maqedonisë. Tetë lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë, të grupuar në gjashtë pellgje ujëmbledhëse e përshkojnë vendin nga lindja në perëndim. Përmbytjet zakonisht janë me prejardhje lumore dhe ndodhin në periudhën shtator-mars, kur në vend bien afër 80-85 për qind e reshjeve vjetore. Pasojat, të cilat dikur mund të zvogëloheshin deri në një nivel të përcaktuar nga investimet e bëra për parandalimin e përmbytjeve, sot stimulohen lehtë për shkak të degradimit të kushteve të sistemit të pritave, të kanaleve të kullimit, ndërtimeve pa kriter mbi objekte dhe zona me rrezik, gjendja e stacioneve të pompimit dhe të pajisjeve të tjera për mbajtjen nën kontroll të përmbytjeve.

Shqipëria ka një histori të gjatë të regjistrimit të përmbytjeve në ultësirën perëndimore. Përmbytja e nëntorit 1962 – janarit 1963, mbahet historikisht si më e madhja.

Më 31 dhjetor 1970 – 1 janar 1971 lumi i Vjosës përmbyti rreth 14.000 hektarë. Përmbytja shkaktoi pothuaj të njëjtat pasoja dhe dëmtime, (dëmtime e shkatërrime të argjaturave, kanaleve ujëtise, urave, stacioneve të pompimit etj.), madje në disa zona të përmbytjes dëmet u llogaritën edhe më të mëdha se ato të shënuara nga përmbytja.

Përmbytje kanë ndodhur në shtator të vitit 2002, tetor 2003 dhe shkurt-mars 2004, dhjetor 2009, janar 2010. Ato u shkaktuan nga prurjet e lumenjve Drin, Gjadër, Erzen, Osom, si dhe disa perrenj e lumenj më të vegjël, si: përroi i Manatisë (në rajonin e Lezhës), përroi i Zezës (në Fushë-Krujë), Drinosi, Gjanica, etj. Ujërat përmbytën kryesisht zonën e Lezhës, Shkodrës, si dhe zona të tjera rurale e tokat bujqësore për gjatë brigjeve të lumenjve të mësipërm.

Paraqitja në hartë përfaqëson përmbytjet e pritshme me një mundësi përsëritjeje një herë në 100 vjet. Me kapacitetet aktuale Plani Kombëtar reflekton mundësinë për përbalimin e një niveli përmbytjesh relativisht më të vogël se ai me përsëritjeje 100 vjet. Sipas përmbledhjes në Studimin për Vlerësimin e Rreziqeve në Shqipëri, përmbytja me mundësi përsëritjeje 100 vjet do të prekte 20 rrethe, 110 komuna, 341 fshatra, 85,500 godina me 7 900 000 m² sipërfaqe ndërtimi dhe 565.000 banorë.

Angazhimi i FA për përbalimin e situatave të Emergjencave Civile

Në përgjithësi, Forcat e Armatosura nuk janë instrumenti kryesor për



përbalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore dhe njerëzore, por në kushtet reale të vendit tonë, përdorimi i tyre është tepër i domosdoshëm. Me burimet që zotërojnë, me shkallën e lartë të organizimit, të disiplinës, të gatishmërisë dhe aftësisë për dislokime të menjëhershme, Forcat e Armatosura janë në gjendje që në momentet e para të japin një kontribut të madh. Në disa rrethana të caktuara, vetëm ato mund të ofrojnë mbështetje të nevojshme logjistike, shpërndarje, komunikim dhe siguri të vijueshme. Këto burojnë nga vetë natyra dhe aftësitë e ushtarakëve për t'u organizuar e për të vepruar shpejt, në një kohë kur strukturat e tjera të pushtetit qendror dhe vendor kanë të pamundur të veprojnë me një ritëm të tillë.

Si rregull, Forcat e Armatosura veprojnë dhe marrin pjesë në emergjencat civile me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes ose të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm në rastet kur kapacitetet civile janë të pamjaftueshme për të reaguar, si dhe në rrethanat kur përdorimi i tyre mund të jetë më me efikasitet në të gjitha këndvështrimet. Mbështetja e strukturave ushtarake plotëson dhe nuk zëvendëson strukturat civile, qendrore apo vendore, të cilat kanë përgjegjësi kryesore në menaxhimin e këtyre situatave. Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura bëhet në varësi të nevojave për reagim të shpejtë, si edhe të nevojave për shërbime shtese të specializuara, tepër të domosdoshme dhe të pamundura nga burimet civile. Forcat e Armatosura mund të dalin nga kazerma, edhe pa u shpallur gjendja e jashtëzakonshme, me kërkesë të pushtetit vendor, për shpëtimitin e jetës së njerëzve në rrezik real dhe potencial, si edhe gjësë se gjallë në pronësi të tyre.

Operacioni "Jugu-2014"

Si rezultat i reshjeve të dendura të shirave në zonat jugore e jugperëndimore të vendit dhe fryrjes, daljes nga shtrati të lumenjve "Vjosa", "Gjanica", "Drino" dhe "Osomi", në disa zona të vendit ndodhën përmbytje të bane-save, pronave dhe akteve rrugore si në Urën Vajurore të Qarkut Berat, në aksin Memaliaj-Tepelenë, në Qarkun e Gjirokastrës, në Komunën e Novoselës të Qarkut të Vlorës si dhe në disa fshatra përgjatë lumit Vjosa, në Qarkun e Fierit.

Nga përmbytjet e shkaktuara, u vu në rrezik jeta e banorëve në këto zona, u shkaktuan vështirësi në qarkullimin rrugor dhe dëme të mëdha në të mbjella dhe gjënë e gjallë të banorëve.

Për përbalimin e situatës së krijuar, Ministri i Mbrojtjes, mbështetur në Ligjin nr.10435, datë 23.06.2011, "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në RSH", VKM, nr.742, datë

”

Mbështetja e strukturave ushtarake plotëson dhe nuk zëvendëson strukturat civile, qendrore apo vendore, të cilat kanë përgjegjësi kryesore në menaxhimin e këtyre situatave. Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura bëhet në varësi të nevojave për reagim të shpejtë, si edhe të nevojave për shërbime shtese të specializuara, tepër të domosdoshme dhe të pamundura nga burimet civile.

16.10.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e QKKSH", ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001, "Për Emergjencat Civile", miratoi përdorimin e Forcave të Armatosura, në zonat e prekura nga përmbytjet, për kryerjen e operacioneve të kërkim shpëtimit dhe evakuimit të njerëzve dhe gjësë së gjallë nga toka dhe ajri.

Me marrjen e kësaj detyre, Shtabi i Përgjithshëm i FA, Qendra e Bashkuar Operacionale/Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit të FA dhe të gjitha kapacitetet e gatshme të deklaruara nga strukturat e FA-së, për përbalimin e situatave emergjente u vunë në gatishmëri dhe u angazhuan në operacione evakuimi të popullsisë së përmbytur në jug të vendit.

Angazhimi i Forcave të Armatosura

Më datën 31.01.2015, ora 20.30,



Me kërkesë të Emergjencave Civile të Qarkut Gjirokastrë u vunë në dispozicion një mjet kamion tip Iveco dhe një efektiv prej 10 vetë për zhbllokimin e rrugës Gjirokastrë Kakavijë.

Më datën 01.02.2015, me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile të Ministrisë Brendshme dhe me urdhër të SHSHP të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, Komanda e Forcës Tokësore (Reparti Ushtarak Nr.1030) vendosi në dispozicion të Emergjencave Civile Berat në Bashkinë Ura-Vajurore, një efektiv prej 30 vetësh dhe 3 mjete transporti për evakuimin e njerëzve të përmbytur nga reshjet e shiut. Gjatë operacionit u evakuuan rreth 50 persona.

Me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile të Ministrisë së Brendshme dhe me urdhër të SHSHP të FA Gjeneral Major Jeronim BAZO, Komanda e Forcës Ajrore angazhoi një helikopter në operacion shpëtimit në rajonin Memaliaj u evakuua 1 person.

Komanda e Mbështetjes angazhoi 20 persona, 3 mjete, 2 motobarka dhe 4 gomone në operacion evakuimi të popullsisë në rajonin e komunës Novoselë. Gjatë operacionit u evakuuan 27 persona

Në zbatim të urdhrat të MM dhe






OPERACIONI "JUGU-2015"

Si rezultat i reshjeve të dendura të shirave në zonat jugore e jugperëndimore të vendit dhe fryrjes, daljes nga shtrati të lumenjve "Vjosa", "Gjanica", "Drino" dhe "Osumi", në disa zona të vendit ndodhën përmbytje të banesave, pronave dhe akseve rrugore si në Urën Vajgurore të Qarkut Berat, në aksin Memaliaj-Tepelenë, në Qarkun e Gjirokastrës, në Komunën e Novoselës të Qarkut të Vlorës si dhe në disa fshatra përgjatë lumit josa, në Qarkun e Fierit.

ANGAZHIMI

Më datën 01.02.2015, me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile të Ministrisë Brendshme dhe me urdhër të SHSHP të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, Komanda e Forcës Tokësore (Reparti Usharak Nr.1030) vendosi në dispozicion të Emergjencave Civile Berat në Bashkinë Ura-Vajgurore, një efektiv prej 30 vetësh dhe 3 mjete transporti për evakuimin e njerëzve të përmbytur nga reshjet e shiut. Gjatë operacionit u evakuuan rreth 50 persona.



SHSHP të FA-së në orën 21:05 u nisën nga KM për në Komunën Levan, Fier dy mjete të kalueshmërisë së lartë për evakuimin e banorëve të përmbytur.

Me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile të MB dhe me urdhër të SHSHP të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, Shkolla e Trupës/QSI Bunavi vendosi në dispozicion të Emergjencave Civile Vlorë në rajonin e Komunës Novoselë, një efektiv prej 7 vetësh dhe 3 mjete transporti për evakuimin e njerëzve të përmbytur nga reshjet e shiut. Gjatë operacionit u evakuuan 118 persona dhe 2 mjete civile.

Më datën 02.2.2015, në zbatim të detyrës të SHSHP të FA-së për angazhimin e forcave dhe mjeteve në Komunën Novoselë Vlorë dhe në fshatrat përreth kësaj komune, ka vazhduar operacioni me 20 forca, 3 mjete, 2 motovarka dhe 4 gomone të batalionit të mbështetjes rajonale dhe 2 forca dhe 2 mjete me efektiv të batalionit transportit KM.

Efektivat e batalionit mbështetjes rajonale evakuuan 5 persona të ngelur në banesa, si dhe shpërndanë ndihma

të ndryshme për popullatën e komunës së Novoselës.

Efektivat e Batalionit të Transportit me dy mjete transportuan familje të përmbytura nga fshati Ferraj për në Komunën Levan të Fierit.

Shkolla e Trupës (QSI) Bunavi KDS mori pjesë në Operacion në komunën Novoselë, me një efektiv prej 10 vetësh dhe 4 mjete transporti për evakuimin e njerëzve të përmbytur nga reshjet e shiut. Gjatë operacionit u evakuuan 35 persona dhe u shpërndanë ndihma ne familjet e dëmtuara.

Forcat e Armatosura pjesëmarrëse në operacion gjithsej 232, mjete transporti 29, motovarka 2, gomone 4. U evakuuan gjithsej 40 persona, dy mjete civile, transportuan forcat e rendit për në fshatin Hoxharë si dhe morën pjesë në Operacionin e shpërndarjes së ndihmave për popullatën në nevojë.

Më datën 03.02.2015, në Komunën Novoselë, Vlorë dhe në fshatrat përreth kësaj komune, ka vazhduar operacioni me 20 forca, 3 mjete, 2 motovarka dhe 4 gomone të batalionit të mbështetjes rajonale dhe 2 forca dhe 2 mjete me efektiv të batalionit transportit KM.

Është bërë pastrim i sipërfaqes ku kalojnë linjat elektrike nga shkurret nga prurjet e lumit në Novoselë, Vlorë dhe transport të 1 varke të Policisë së Shtetit me 1 mjet Iveko në drejtim të fshatit Bashkim, Komuna Ferras.

Në zonën e Bashkisë Ura Vajgurore për pastrimin e shtëpive dhe terrenit nga pasojat e lëna nga përmbytjet e ditës së dielë u punua nga një efektiv me 35 forca dhe 4 mjete të Rep.Usht.Nr. 1030 Poshnje, Berat (FT).

Shkolla e Trupës (QSI) Bunavi KDS mori pjesë në Operacion në komunën Novoselë, me një efektiv prej 17 vetësh dhe 5 mjete transporti për evakuimin e njerëzve të përmbytur nga reshjet e shiut. Gjatë operacionit u evakuuan 65 persona dhe u shpërndanë ndihma në familjet e dëmtuara. Forcat e Armatosura pjesëmarrëse në operacion gjithsej 76 forca, mjete transporti 14, motovarka 2, gomone 4. Evakuuan gjithsej 65 persona, morën pjesë në operacionin e shpërndarjes së ndihmave për popullatën në nevojë dhe transport të 1 varke të Policisë së Shtetit.

Në orën 20.35 datë 03.02.2015, u parkuan 2 mjete vetëshkarkuese në Shkollën e Trupës (QSI) Bunavi, Vlorë ku më datë 04.02.2015 do të punojnë për ngarkim shkarkim dhe transport inertesh për forcim argjinature në vendin e quajtur Laguna e Nartës, Vlorë.

Efektivat Rep.Usht.Nr. 1030 Poshnje, Berat (FT) në rajonin e Bashkisë Ura Vajgurore, u vizitua nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë z.Edi Rama.

Një mjet pompë thithëse uji dhe 17 forca (KM) punuan për largimin e ujerave që rrezikojnë rezervuarin e Maskurisë, Golem rrethi Kavajë.

Përmbledhje e angazhimit të forcave e mjeteve në operacion nga data 01.02.2015 deri më 04.02.2015.

Forca e mjete

- Forca: 250.
- Mjete transporti: 30 copë.
- Zjarrfikëse: 2 cope
- Pompa për tërheqje uji: 4 cope
- Qendër Mobile: 1 copë.
- Autoambulanca: 2 copë.
- Mjete transporti ujqor: 6 motobarka dhe 12 gomone.

- Mjete ajrore: 3 helikopter ; 1 MEDEVAC, 1 SAR, 1 Transport VIP (në gatishmëri)

Puna e bërë:

- Evakuim i 222 qytetarëve të bllokuar nga uji (në fshatin Novoselë, Qarku Vlorë, në fshatin Memaliaj, Qarku Gjirokastrë dhe në fshatin Levan, Qarku Fier).
- Evakuim i 1 familjeje dhe 5 barinj në fshatin Bishan, Novoselë, Qarku Vlorë.
- Zhblokim aksi rrugor, Gjirokastrë-Kakavijë.
- Riparim ure në qytetin Përmet.
- Transport ndihmash ushqimore në fshatin Novoselë, Qarku Vlorë dhe në fshatin Darzezë, Qarku Fier.
- Transport i forcave të rendit (MB) në fshatrat Hoxharë dhe Levan, Qarku Fier.
- Pastrim inertesh tek Ura Vajgurore, Kuçovë.
- Pastrim i linjës elektrike në fshatin Novoselë.
- Forcim argjinature tek argjinatura e Lagunës së Nartës
- Angazhim për tërheqje të ujit që rrezikon rezervuarin e Maskurisë, Bashkia Kavajë.
- Forcim argjinature tek Ura e Mifolit, në fshatin Fitore, Vlorë
- Pastrim i shtëpive nga mbetjet e ndryshme pas përmbytjes..

Për shkak të vijimit të kushteve të këqija të motit, angazhimi i Forcave të Armatosura në operacion për përbalimin e situatës së krijuar në jug të vendit për shkak të reshjeve të dendura të shiut, vijon.

Vlerësimi i situatës së pritshme

Sipas parashikimit meteorologjik në zonat bregdetare dhe veriperëndim do të ketë reshje me intensitet mesatar dhe shtrëngata të herpashershme. Në verilindje dhe juglindje parashikohen reshje bore me intensitet mesatar. Situata në zonat e përmbytura nuk do të ketë ndonjë ndryshim, pavarësisht reshjeve të shiut që mund të bien (kanë intensitet mesatar). Si pasojë e reshjeve të shiut, mund të kemi përmbytje edhe në Qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës. Reshjet e dëborës në zonën veriore dhe verilindore mund të shkaktojnë bllokim

të akseve rrugore dhe baza e ulët e reve mund të bëhet pengesë për ngritjen e helikopterëve në rast se kërkohet ndihmë nga ajri.

Përfundime, rekomandime

Të vazhdojë angazhimi i FA në operacionet e kërkim shpëtimit.

Të vihen e të mbahen në gatishmëri varka të tjera shpëtimi

Të merren masa për përbalimin e situatës së bllokimit të rrugëve nga dëborat. Të vihen në gatishmëri mjetet borëpastruese

Të bashkëpunohet ngushtë me shtabet e emergjencave civile në qarqet e prekura nga përmbytja.

FA të bëhen pjesë e ndërjegjësimi të banorëve për rrezikun që mund të vijë dhe për domosdoshmërinë e evakuimit të detyrueshëm të tyre.

Disa mësim të identifikuar:

Si çdo operacion tjetër edhe ky operacion do t'i nënshtrohet një analize të thellë dhe do të nxirren mësimet për të ardhmen. Paraprakisht, pavarësisht punës së mirë të bërë identifikohen disa probleme si:

- Nevoja e rishikimit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile dhe hartimit të Planit Kombëtar për Kërkim Shpëtimit dhe mbi bazën e tyre të rishikohen planet operacionale

- Identifikimi më i qartë i strukturave përgjegjëse dhe kapaciteteve reaguese të tyre në nivel shtetëror për përbalimin e Emergjencave Civile, bazuar kjo edhe në raportin përmbledhës të Vlerësimit të Rreziqeve nga fatkeqësitë në Shqipëri.

- Të rriten investimet për parandalimin e përmbytjeve si dhe të parandalohen faktorët stimulues të përmbytjeve si: degradimi i kushteve të sistemit të pritave, të kanaleve të kullimit, ndërtimeve pa kriter mbi objekte dhe zona me rrezik si edhe gjendja e amortizuar e stacioneve të pompimit dhe të pajisjeve të tjera për mbajtjen nën kontroll të përmbytjeve.

Përgatiti: Kap. Rang. I-rë Edmond QARRI
Shefi i Sektorit të Vlerësimit të Rrezikut në QBO
Kol@Vait GOLIKJA
Specialist për EC në QBO



Ministrja e Mbrojtjes Kodheli: Guxoni të projektini të ardhmen tuaj

Projektet më të mira do bëhen realitet

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli ishte më 30 janar 2015 në qytetin e Lezhës, në kuadër të iniciativës së ndërmarrë nga kryeministri që secili ministër të adoptojë një shkollë në vend, për ta kthyer në një qendër komunitare. Znj. Kodheli ishte në gjimnazin "Hydajet Lezha" në qarkun e Lezhës ku prezantoi këtë projekt i cili synon thithjen e ideve më të mira të rinjëve dhe kthimin e tyre në projekte reale për komunitetin.

Ajo i ftoi nxënësit të guxojnë të japin idetë e tyre për të ndërtuar qytetin e së nesërme për një të ardhme më të mirë.

Idetë më të mira do të kthehen në projekte reale dhe financimi i tyre do merret përsipër nga qeveria në bashkëpunim me donatorët.

Në kuadër të fushatës për rekrutimin e të rinjëve për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura, znj. Kodheli përfitoi nga rasti të ftojë gjithë të rinjtë lezhjanë ta shikojnë këtë si një mundësi të mirë për të pasur jo vetëm një vend të sigurtë pune por edhe për t'i shërbyer vendit dhe sigurisë, një ndër sfidat më të mëdha të ditëve të sotme.



Zhvillohet konferenca e parë planëzuese e stërvitjes rajonale "Adrion-Livex-2015"

Rritja e bashkëpunimit në fushën e sigurisë detare

Shqipëria organizon edicionin e dhjetë të stërvitjes në sistemin e rotacionit të vendeve pjesëmarrëse

Në Komandën e Forcës Detare, më 29 janar 2015 u zhvillua konferenca e parë planëzuese e stërvitjes rajonale "Adrion - Livex - 2015". Në këtë konferencë morën pjesë kadro drejtues dhe organizues të kësaj stërvitjeje nga vendet pjesëmarrëse të iniciativës "Adrion", konkretisht nga Shqipëria, Kroacia, Greqia, Italia, Mali i Zi dhe Sllovenia.

Iniciativa "Adrion", është një nismë bashkëpunimi midis vendeve të Adriatikut dhe Jonit dhe ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit në fushën e sigurisë detare. Këtë vit është edicioni i dhjetë i kësaj stërvitjeje, ku bazuar në sistemin e rotacionit të vendeve pjesëmarrëse, vendi organizator i kësaj stërvitjeje është Shqipëria. Është hera e dytë kur detarët tanë, mbas stërvitjes "Adrion-Livex" të zhvilluar në vitin 2009, do të jenë protagonistë dhe mikpritës të kësaj stërvitjeje, ndaj ky event kërkon përkushtim dhe përgjegjësi të madhe. Për realizimin me sukses të kësaj stërvitjeje janë marrë të gjitha masat organizative dhe teknike nga Komanda e Forcës Detare dhe strukturat përkatëse në flotilje dhe anije.

Në konferencën e parë të kësaj stërvitjeje u prezantua dhe diskutua qëllimi, objektivat, pjesëmarrësit, mjetet, situatat detare, rajoni, formacioni i anijeve, radio - komunikimi, etj. E veçantë në këtë stërvitjeje është që për herë të parë po bëhen përpjekje maksimale për të përmbushur STANAG e NATO. Në ndihmë të këtij objektiv madhor është dhe Qendra e Simulimeve shqiptaro - amerikane në



Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes. Kështu specialistët e kësaj qendre, zoti Tony Darlington dhe major Lulëzim Salihi i shpjeguan pjesëmarrësve radhën dhe modalitetet që përdorin sektorët përkatës në strukturat e NATO për këto lloj stërvitjesh. Gjithashtu në mars të këtij viti në këtë qendër do simulohen të gjithë skenarët e mundshëm të kësaj stërvitjeje të madhe

detare, e cila do finalizohet në qershor të këtij viti.

Gjatë konferencës specialistët e Degës së Planifikimit dhe Operacioneve në Komandën e Forcës Detare, si dhe përfaqësuesit e flotave pjesëmarrëse, LT. Nikola Basic (Kroaci), LT. Paulo Calvaruso (Itali), kapiten i rangut të II Iosif Papadakis (Greqi) dhe LT. Ivan Lakovic (Mali i Zi), prezantuan

dhe diskutuan variantet dhe detajet e mundshme të stërvitjes detare rajonale "Adrion - Livex - 2015".

Konferenca u drejtua nga kapiten i rangut të I Adnand Agastra, shef Shtabi i FD, i cili vlerësoi punën cilësore që është bërë në përgatitjen e kësaj konference përgatitore dhe në emër të komandantit të Forcës Detare falënderoi pjesëmarrësit.

Deklaratë për shtyp



E enjte,

05 shkurt 2015 15:44

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë prej më se një viti kanë nisur një proces gjithëpërfshirës e të vijueshëm për forcimin e disiplinës dhe rregullit ushtarak brenda strukturave të tyre. Ngjarja e ndodhur me major Sokol Feka, përbën një shtysë në kryerjen më me cilësi të këtij procesi.

Në këtë kuadër, për thyerje të rëndë të disiplinës, Policia Ushtarake ka bërë ndalimin e dy ushtarakëve, një major dhe një kapiten, si të dyshuar për lidhjet e tyre me majorin e përfshirë në ngjarjen e ndodhur. Për të hedhur dritë të plotë mbi dyshimet e ngritura, Policia Ushtarake po bën kallëzimin në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.

Për sa më sipër, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA qëndrojnë të vendosur për të vijuar më tej thellimin e masave për forcimin e disiplinës në interes të kryerjes me sukses të misionit të tyre dhe ruajtjes së dinjitetit të figurës së ushtarakut.



Flet Prof. Niko Pano, inxhinier hidroenergjitik

ALBERT Z. ZHOLI

"Ja pse ndodhin përmbytjet në Jug"

Një gjendje e vështirë, e jashtëzakonshme. Shkurti ka hyrë me dëme të mëdha dhe shira të rrëmbyeshëm. Më shumë se një javë që po ndodhin përmbytje pa masë. Përmbytje të pa imagjinuara. Jugu i Shqipërisë po kalon një situatë të vështirë për shkak të reshjeve të shumta të cilat kanë sjellë përmbytje dhe shumë dëme materiale. Shumë shtëpi janë bërë të pabanueshme, shumë bagëti i kanë marrë rrymat e ujit. Me gjithë masat e shumta administrative të shtetit, dëmet janë të pallogaritshme. Lind pyetja: Pse kanë ndodhur përmbytjet në jug? A është fajtoresha qeveria e sotme siç mundohen ta paraqesin disa pseudoanalistë? Sipas një prej specialistëve më të mirë të burimeve hidrike Prof. Niko Pano, shkaqet janë të shumta por që zgjidhja kërkohet në shkencë dhe jo vetëm në masat administrative. Sigurisht që qeveria po merr masa të mira, por janë të pamjaftueshme, pasi problemet janë të mbartura theksojnë specialistët. Vendi ynë është një vend me reshje të shumta, ndër vendet me reshje më të mëdha në Europë dhe përmbytjet do të jenë gjithmonë prezent, por nga ana tjetër, për 25 vjet janë prishur shumë kolektorë, hidrovorë, delta të lumenjve, sikundër janë bërë ndërtime dhe në zona ujëmbajtëse. Por kryesorja është që në 25 vjet demokraci nuk është ndërtuar asnjë kaskadë e re si e Fierzës që të pengojë përmbytjet. Ja si shprehen dy specialistët e mirëfilltë për gjendjen në jug

Të gjithë mediat diskutojnë për përmbytjet. Reshjet problemi i ditës në Shqipëri ku kemi dhe dëme të mëdha materiale. Nga se kanë ardhur këto dëme dhe a ka faj shteti?

Nuk e di si mendojnë analistët. Këto janë fatkeqësi natyrore që e kanë origjinën vite më parë. Po shoh një qeveri të mobilizuar dhe një ushtri që gjendet në ballë të situatës. Ata që nuk e shohin punën e qeverisë dhe të ushtrisë, problemet ti shohin tek vetja. Ushtria është e pranishme kudo. Situata është tepër e vështirë, tejet e dhimbshme, me gjithë masat që po merr qeveria. Këto janë probleme të mbarsura për 25 vjet, ku nuk është punuar me strategji për të përballuar situata të tilla. Në këto 25 vjet, Shqipëria është lënë në mes të katër rrugëve, si mall pa zot. Këto përmbytje kanë ardhur sepse: -Janë pri-



shur të gjitha argjinaturat dhe kanalet e dyta dhe të treta të kullimit të ujërave në tokat e punueshme. Janë prishur thuajse të gjitha stacionet hidrometeorologjike, të cilat paralajmëronin situata të tilla. Lumenjtë kanë devijuar nga shtretërit, si rezultat i ndërtimeve dhe marrjes së inerteve pa llogari, dhe si zot që këto shtretër të mund të disiplinohen më. Brezat pyjorë që ishin mbjellë për luftë kundër erozionit (gërryerjeve), janë prerë dhe shkatërruar në mënyrë të përbindshme. Pyjet nëpërmjet rrënjëve të pemëve thithin 70 % të ujit, që tashmë kalon në gjendje të lirë, pa pengesë. Janë prishur hidrovoret dhe të gjitha kolektorët.

Por të vijnë tek arsyt shkencore të kësaj katastrofe natyrore?

Këtu do ndalem në komentet specifike. Arsyet janë të shumta. Kemi lartësi mesatare të madhe të relievit, intensitet të madh reshjesh dhe reliev të thyer. Nuk po ndërtojmë kaskadat e tjera në Devoll, Vjosë Shkumbin që kështu me këto projekte frenojmë prurjet maksimale. Jemi shumë të ekspozuar ndaj reshjeve. Por, ky problem nuk zgjidhet vetëm me masa administrative, situata duhet menaxhohet shkencërisht dhe jo vetëm administrativisht. Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mjedisit, dhe ajo e

Energjetikës pas këtij momenti duhet të bëjnë një plan shkencor, pasi projektet për kaskadat janë gati. Të gjitha qeveritë e mëparshme nuk i kanë zbatuar projektet e kaskadave, i kanë injoruar!! Pse kanë ndodhur përmbytjet në jug? Sepse Shqipëria ka një potencial të lartë hidrik, madje jemi vendi me potencial më të lartë, më të madh në Europë, Ne kemi modulën e rrjedhjes 30 metër në sekondë për kilometër katror, nga më të lartat në Europë, ku reshjet shkarkojnë 1308 metër kub ujë në sekondë. Kemi variacione të mëdha gjeofizike, d.m.th, prurjet në dimër janë shumë të larta, dhe e dyta ka variacione ndaj ciklit 100-vjeçar. Pra kemi një potencial ujor shumë të fuqishëm, por shumë delikat, shumë aristokrat. Atëherë ndryshimet klimaterike janë shumë më të ndjeshme në Shqipëri se vendet e rajonit por do të jenë akoma më të ndjeshme në të ardhmen. Prandaj nëse hidroekonomia shqiptare nuk do mbështet në shkencë, por do të mbështetet vetëm në administratë dhe në masa administrative si kanale, hidrovore, kullime (pra nëse nuk do të menaxhohet shkencërisht) problemet do të jenë edhe më serioze. Jam shumë dakord me masat e qeverisë, ato janë të domosdoshme dhe efikase,

por janë shumë të përkohshme. Ne duhet të jemi shumë më të ndjeshëm ndaj impaktit të ndryshimeve klimaterike, pasi jemi shtet me potencial të madh ujor. Reshjet në Shqipëri arrijnë nga 450-500 mlm në vit. Pra ka një shkarkim të jashtëzakonshëm të reshjeve të cilat sjellin prurje të mëdha. Ndaj shkenca shqiptare duhet t'i dali zot, dhe ta menaxhojë hidroekonominë shqiptare. Është normale që vendi ynë është i ndjeshëm nga këto dukuri. Dhe baza e këtyre problemeve sot është impakti i ndryshimeve klimatike. Por ne nuk po shfrytëzojmë kapacitetin hidroenergjetik të vendit.

Mund të na përcaktoni disa karakteristikat të prurjeve të lumit Vjosa?

Për Vjosën flitet shumë. Këto ditë është prezentë në çdo familje. Vjosa e ka prurjen maksimale në 100 vjet 4.450 metra kub ujë në sekondë. Volumi i prurjes maksimale, të plotë, është 888 milion metër kub ujë. Kjo prurje e plotë vazhdon 5-6 ditë. Aftësia ujë heqëse, ujë thithëse, e lumit drejt detit është 2500 metër kub në sekondë, që kështu, gati 2.000 metra kub ujë dalin jashtë shtetit dhe bëjnë përmbytjet. Është shqetësuese, por kjo situatë dëmin më të madh e sjell në zonën e bregdetit dhe

që e degradon atë.

Të ndalemi tek degradimi. Si degradohet toka dhe cila është kjo zonë që degradohet?

Degradimi sot është në rend të ditës. Sot në Shqipëri shikon shumë toka të degraduara që deri dje ishin toka pjellore. Zona e degradimit nga këto reshje është nga Zvërneci deri në derdhjen e Semanit. Ky degradim që ndodh, e ka kthyer tokën në të pashfrytëzueshme. Kështu krijohet difuzioni i kripës, sepse uji i kripur me ujën e ëmbël përzihen. Është e papranueshme që kjo tokë, kjo hapësirë kaq e bukur, dikur aq pjellore, të mbetet e pa shfrytëzuar për shkak të kripëzimit. Nuk është e pranueshme që grykëderdhja kaq e bukur të lihet në mëshirën e ujit të pa orientuar. Përmbytja degradon territorin, jo vetëm njerëzit. Në Holandë toka fitohet nga deti, ne e kemi dhe ja falim detit.

Ka mënyra se si mund të rregullohet apo anashkalohet përmbytja?

Një program interesant, plot me këngë patriotike, recitime dhe tinguj kitarë nga autorë të ndryshëm. Të gjitha këngët dhe recitimet kishin një frymë të thellë edukuese. Ky koncert ku kishte mbledhur në sallë më shumë se 150 vetë, u hap me këngën e korit "Globi rrotullohet", një këngë shumë e dashur për fëmijët, një këngë që të zgjon dëshirën për të mësuar në thellësitë e globit tokësor, në pafundësinë e hapësirave të tij, vendndodhjen e atdheut tonë të dashur, Shqipërisë. Më pas vjen një interpretim në kitarë dhe disa recitime. Koncerti vazhdon me repertorin e të gjithë korit me këngët "Globi rrotullohet", "Festa e abetares", "Tring zilja", "Potpuri këngësh korçare", "Gjyshes sime", "Në shtëpinë tonë" dhe së fundi kënga himn "Dua më shumë Shqipërinë". Kjo këngë e ndezi më shumë atmosferën. Bashkë me fëmijët tashmë këndonin edhe prindërit. Prindërit ngrihen në këmbë dhe duke kënduar bashkë me fëmijët marrin pjesë në gëzimin e tyre, marrin pjesë në dhuntitë dhe preferencat e tyre jetësore. Nga ky grup për çdo vit kanë dalë këngëtarë, instrumentistë, piktorë që kanë bërë emër dhe kanë marrë pjesë në kompeticione të rëndësishme televizive. Fëmijët këndojnë me gjithë zemër. Zërat e tyre të bukur çajnë grinë e kësaj të shtune duke tërhequr edhe vëmendjen e kalimtarëve. Një këngë frymëzuese, për atdheun tonë, për Shqipërinë, që fëmijët i mbush me gëzim dhe forcë. Është një këngë me një muzikë dhe tekst të mrekullueshëm që të rrëqeth dhe të bën të vetëdijshëm për përgjegjësinë e emrit që mbart mbi vete. Entuziazmi i fëmijëve nuk njihet kufij dhe ata në vargjet e fundit, kapin për dore njeri-tjetrin dhe lëvizin trupat në harmoni si valë deti, për të përcjellë dashurinë që kanë për atdheun e tyre Shqipërinë. Kur kënga mbaron, fëmijët përqafohen me njeri-tjetrin dhe pastaj me prindërit gjyshet, apo gjyshërit. Një moment tejet emocional. Përqaftime, lot gëzimi, mirënjohjeje, dëshire për të qenë kështu të bashkuar në emër të artit, këngës, magjisë së saj, që mrekullon çdo kënd. Kjo është kënga, muzika, që të përcjell mirësi, gëzim, harmoni, vëllazërim.

Redon Makashi, kantautor

Unë si pjesëtar i Qendrës Kulturore



të Ushtrisë, ku kam katër vjet, mund të them se në çdo fund muaji ne organizojmë një koncert me këngë, recitime dhe interpretime në kitarë nga fëmijë të ndryshëm. Ky aktivitet është një aktivitet i parë në vitin e ri 2015, pas atij koncerti të bukur në fund të vitit 2014. Në këtë rast koncerti është një zë i veçantë midis festës së Republikës që kali më 11 janar dhe Festës së 14 shkurtit që po vjen. Në këtë koncert janë gjetur element të rinj, këngë të reja apo pjesë instrumentale që nuk janë nuk janë luajtur më parë. Funkcioni im në këtë institucion është të jap mësim në veglën e kitarës, një instrument i cili pëlqehet shumë nga fëmijët. Numri i tyre vjen duke u rritur nga dita në ditë, pasi fëmijët janë shumë kureshtar ndaj këtij instrumenti. Nga gjiri im këtij institucioni kanë dalë instrumentistë të vegjël të cilët kanë konkurruar në kompeticione të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Për mua ky institucion është një shkollë e vogël, ku fëmijët vijjnë me shumë dëshirë dhe pyesin pa ndroj. Kitarra është një instrument

shumë i bukur, mjaft i përhapur, ku fëmijët bëjnë dhe pyetje befasuese. Unë ndihem mirë mes tyre, ndihem i privilegjuar, më duken të gjithë si fëmijët e mi. Këtu ata marrin shumë dituri dhe mund të them se në çdo koncert do të ketë fëmijë që do të luajnë pjesë të ndryshme në kitarë. Në këto koncerte kanë luajtur dhe 5 fëmijë me kitarë. Por ne na vijnë fëmijë të mësojnë edhe në mes të kursit. Pra shtohen çdo ditë. Fëmijët shprehin se ndihen shumë të gëzuar dhe të motivuar në këto kurse, dhe falënderojnë Ministrinë e Mbrojtjes për këto kushte dhe hapësira të mëdha. Në këto katër vjet që kam këtu, kam nxjerrë më shumë se 30 instrumentistë ku mund të them se ka pas dhe shumë vajza. Disa thonë si ka pasur vajza në kitarë?! Po, ka pasur më shumë se gjashtë vajza. Disa prej tyre kanë vazhduar Liceun. Madje dhe më tej. Kursi është çdo të shtunë dhe zgjat aq sa duan fëmijët. Sot ishte një koncert i bukur, plot gjallëri, plot variacione, ku fëmijët ishin tejet të gëzuar dhe të obliguar. Janë koncerte që përcjellin mesazhe atdhedashurie

dhe respekti. Pra janë model i edukimit dhe harmonisë mes fëmijëve. Të tilla koncerte do të quaja të veçantë.

Erind Bajo, nxënësi që mëson për kitarë

Unë jam në klasë të dytë të shkollës 9-vjeçare "Pal Engjëlli". Kam dy vjet e gjysmë që vij në këtë kurs dhe mësoj për kitarë. Fillimet e para për mësimin e kitarës janë me babanë tim. Ai e përdor shumë kitarën dhe më nxiti dhe mua dëshirën. Unë kam kitarë në shtëpi dhe luaj dy orë në ditë. Por nuk e teproj pasi kam dhe mësimet. Këtu në kurs vij me shumë dëshirë pasi mësoj shumë dhe xhaxhi Redoni na mëson shumë mirë. Këtu ka kushte shumë të mira dhe shokë e shoqe shumë të mirë. Koncertet më nxisin të mësoj më shumë. Kur të rritem dua të bëhem një kitarist i mirë. E dua shumë muzikën. Ajo më qetëson dhe më gëzon shumë.

Kozma Dushi, këngëtar

Ishte një koncert specifik midis dy festave në kuadrin e koncerteve të çdo fund muaji që organizon Qendra jonë e Kulturës. Shihet se nga dita në ditë po

rritet numri i fëmijëve që marrin pjesë në grupet tona të këngës, aktrimit dhe instrumenteve muzikorë. Kjo tregon se Qendra jonë ka profesionalizëm dhe kërkesa ndaj fëmijëve. Ne po përpiqemi që ata të jenë tek ne të afruar, të qetë, të dashur. Përpiqemi që tu mësojmë sa më shumë për këngën, për instrumentet muzikorë. Përpiqemi që tu mësojmë sa më shumë këngë të reja, këngë të bukura, këngë me mesazh, këngë patriotike. Dashuria e tyre për muzikën rritet nga dita në ditë. Çdo fundjavë ata këtu gjejnë miqësi të reja, gjejnë ngrohtësi, këngë të reja, muzikë të re. Formësohen në muzikë por dhe në respektin për artin, dijen dhe atdheun. Mund të them diçka që, para disa kohësh në koncerte të tilla, fëmijët këndonin me superpozim me CD, ndërsa tani këndojnë live, këndojnë me zërin e tyre të vërtet. Kjo është e veçanta e aktiviteteve tona. Në këtë koncert çdo këngë ishte live dhe me muzikë live. Sot ata mund të kenë bërë ndonjë gabim në të kënduar. Por më mirë. Në kështu i vërejmë gabimet, i shohim, i korrigjojmë. Kështu bëhemi më të vetëdijshëm se deri ku mund të arrijmë. Ky koncert na solli shumë risi por mbi të gjitha fëmijët i kënduan me zemër dhe shpirt atdheut të tyre. Ata morën dhe përcollën një mesazh shumë të qartë "Ta duam më shumë Shqipërinë".

Duart e mirësisë

Tek tundin duart në ajër pas suksesit të koncertit vetiu në gji ndjen një ngazëllim. Një fjalë e urtë thotë, tek fëmijët, se si rriten ata, shikohet e ardhmja e atdheut. Kur i shikon se si shpërndahen, ata duken si një lëndinë lulesh që përcjellin një mozaik ngjyrash dhe zërash që të relaksojnë. Kënga, muzika i bën ata dhe më të bukur dhe më të qeshur. Përcjellin tek njeri-tjetri një dashuri dhe mirësi të dliurë, pa asnjë paragjykim. Tundin duart në ajër që në grinë e ditës, duken si ylber ngjyrëshumë që rrezatojnë dritë. Në përqaftimet e tyre ka një ngrohtësi shpirtërore që barazohet me engjëjt.



SHEFQET KËRCELLI

20 vjet në bazë, një jetë mes repartit dhe familjes, Mjeshtri
që e filloi karrierën e n/oficerit me Motovedetën R-216

Motori është zemra e anijes, më tepër duhet mëndje se sa forcë



”

Nuk ka gjë më të bukur se të shpëtosh jetë njerzish, kur krahe njerzish duken mes valëve të egra të detit të kërkojnë ndihmë, dhe ti i afrosh duke i dhënë shpresë për jetën

Çdo detar, oficer, n/oficer ose marinar i thjeshtë ka një rast të veçantë kur ka veshur uniformën e bukur të marinarit dhe kur është bërë pjesë e pandarë e detit, një kontakt e ndjesi që nuk e harron gjatë jetës. Dhe për dukatën Besnik Berdoj, jeta e detarit filloi me një sprovë të vështirë. Ai duhet të provonte aftësitë e tij si mekanik duarartë duke vënë në gatishmëri Motovedetën, {M/V}, R-216, e cila ishte pjesë e dhuratës prej 5 anijesh të Departamentit të Shtetit të SHBA, në mars 1999. Sipas projektit tre motovedeta shkuan në Bazën e Pashalimanit dhe dy në bazën e Kepit të Palit. Motovedeta R-216, gjatë transportit kishte pësuar një difekt, i cili duhej riparuar për ta vënë në punë. Ishte muaji gusht dhe anija ende ndodhej në bazën e Kepit të Palit, ndërkohë që duhej tu bashkohej anijeve simotra në bazën e Pashalimanit. Për hir të së vërtetës duhet të pranoj se ka një siklet për ne gazetarët me detarët dhe specialistët e zotë: sepse s'është e lehtë t'i nxjerrësh kollaj nonjë fjalë për veten. Por më në fund e binda Besnikun, të na tregojë këtë ngjarje të veçantë që lidhet me një moment të rëndësishëm të Forcës sonë Detare. Pasi mora vesh për difektin dhe gjendjen e anijes, thotë ai, i shkova Komandantit të bazës në zyrë dhe i thashë: "Pse e lemë Motovedetën atje? Ajo është një dhuratë e çmuar, që nuk na vjen kollaj". "Nuk e riparojmë dot!" qe përgjigja. Mbështetur në aftësitë e mija dhe kolegëve i thashë komandantit se do e riparojmë! Jo e bën, jo se bën, biles u vu dhe kushti po e bëre do e gëzosh anijen, po s'e bëre do ikësh nga flota!? Me këto fjalë dhe një ankth të lehtë u nisëm drejt Durresit me shokët e mi. Mbas i bëmë një kontroll të shkurtër skafit dhe lokalit të motorrave e rimorkjuam me M/V 215 dhe e sollëm në Pashaliman. Pas 21 ditë pune, anija doli në det të hapur. Në këtë mënyrë unë fitova bastin dhe sfidën. U lidha ngushtësisht me këtë anije të fuqishme, duke ndarë me të plot gëzime, shqetësime e ngjarje, jo pak, por 8 vjet. Gjithë jetën ëndëroja ta vishja këtë uniformë të bukur, kam jetuar pranë detit, shikoj nga afër ushtarakët marinarë që i jepnin gjallëri qytetës sonë të Orikumit, por s'kisha mundësi të vishja uniformën e marinarit. Kam qenë i persekutuar e s'më lejohej t'i hidhja sytë bazës detare, tregon mekanik Besniku.

Anija e mirmbajtur teknikisht, përballon çdo operacion në det...

Besniku i takon brezit të viteve '50. Ai ka lindur në Dukat, ku kreu arësimin fillor e 8-vjeçar dhe më pas shkollën mekanike bujqësore në Orikum. Këtu ai u lidh përjetësisht me hekurat, siç thotë dhe vetë. Fillori punë mekanik në bazën mekanike Orikum, pastaj shofer kamioni 32 tonësh. Në vitet 1993-1997, ka çuar me qindra m3 gurë në rindërtimin e portit të Vlorës, madje kamionin e parë në molin "0" të këtij porti e ka hedhur Besniku. Duke u marrë me punë mekanike, krijova një farë vetbesimi në riparimin e mirmbajtjen e mjeteve të ndryshme, thotë ai. Kjo eksperiencë e fituar rrugëtimeve të gjata, herë dhe me difekte, ditë e netë pa gjumë, më krijoi bindjen për t'u bashkuar në radhët e Flotës. Rasti e solli që të vihen në provë përvoja dhe aftësitë e mija. Motovedeta R-216, gjatë transportit kishte pësuar difekte në dinam, motorino, një kingston i bllokuar, pompë uji e bllokuar, duhej përshtatur sistemi elektrik nga 110 V në 220 V, etj. Ju futëm punës me këmbëngulje, shpesh duke harxhuar dhe nga xhepi, ndërsa çdo nevojë për transport e mbulua me makinën time. Por nuk më mungoi dhe ndihma e kolegëve në Pashaliman e Kepin e Palit, me çfarë të

kishin mundësi. Psh. një rast në dukje i thjeshtë, por sediljet e MV, mi dhuroi një oficer i ri, zv/komandant i MHM-112 atëhere, kapiten Rezart Bajollari. Fjala ishte fjalë. Kështu mbas 21 ditë e netë pune e sakrifice, R-216-ës, ju bë motori më i mirë, krahas shërbimeve teknike prefekte. Kështu anija përballoi me sukses dhjetra operacione e stërvitje në det të hapur. Nga ajo ditë e nxehtë gushti unë u caktova k/motorist i saj dhe nuk ju ndava plot 8 vite, tamam si vëllezrit siamezë. Anija nuk ngeli anjë ditë pa dalë në det, sa në ujërat e Jonit e Adriatikut, duke u bërë mbretëreshë e gjirit të Vlorës e zot i ujërave përth Sazanit. Ka marrë pjesë në mbi 50 operacione detare, ku veçohet operacioni "Puna" në vitin 2002, dhe dhjetra operacione kërkim-shpëtimi. Nuk ka gjë më të bukur se të shpëtosh jetë njerzish, kur krahe njerzish duken mes valëve të egra të detit të kërkojnë ndihmë, dhe ti i afrosh duke i dhënë shpresë për jetën. Kam dhjetra raste të tilla, por do përmend një rast në derdhje të Semanit, kur peshkarexa "Baxho", kërkoi ndihmë, thjesht me një thirje celulari. Ne ndodheshim në molin e Sazanit, dhe brenda pak minutash, me "arushën" tonë M/V-216, u gjendëm në vendngjarje. Pashkatorja "Baxho" me dy vëllëzërit Bashkim e Engjëll Durmishi në bord, rrezikohej të mbytej. Në sajë të veprimeve të shpejta të ekipazhit tonë u bë e mundur shpëtimi dhe sjellja e tyre në portin e Vlorës. Tashmë vëllëzërit Durmishi kanë ngritur një Qendër Peshkimi në Radhimë, ku shijojnë djersën dhe mundin e punës së tyre në det, por nuk harrojnë humanizmin

dhe sakrificat e detarëve të MV-216, për të shpëtuar jetët e tyre. Detarët tanë janë të mirëpritur në qëndrën e tyre të peshkimit dhe lokalit "Labëria". Një rast tjetër i erdhëm në ndihmë tragetit të linjës Vlorë-Bari, i cili 3 milje në veriperëndim të Sazanit rrezikohej të kthehej mbrapsht në brigjet e ishullit, nga deti 6-7 ballë... Kështu kudo ku ka pasur fatkeqësi apo avari detare, thuajse në cdo koordinatë të Jonit, mezokanalit e Adriatikut, R-216 ka qenë atje, në kohën dhe vendin e duhur. Ndërkohë krahas këtyre operacioneve të vështira e të rrezikshme, ku herë-herë është rrezikuar dhe jeta e ekipazhit të anijes, M/V-216, ka qenë pjesëmarrëse në të gjitha stërvitjet e përbashkëta brenda FA, ose me vendet partnere. Motorat e saj tip Diezel, Detroit, kanë gumëzhirë gjithë kohës në sajë të kujdesit të përherëshëm të Besnikut, si dhe motoristëve të talentuar Vaso Jazo, Viron Breshani, Roland Cane, Jako Kojani, detar Marenglenit, etj. Me këta specialistë kemi riparuar difekte në mes të detit, që nga tubot e ujit, etj. Por, këto anije kanë qenë në duar të sigurt se i kanë drejtuar dhe komandantët të zotë, djem të rinj, të sprovuar në det, si Dritan Serraj, Tomorr Sinani, Olsi Avduli, Julian Tiku, Everest Haxhiu, Ermal Xhelilaj, Fatmir Likskëndaj, etj. shumica e të cilëve janë trajnuar në SHBA.

M/V 216, ka mundësi të lundrojë për vite të tëra

Që nga marsi i '99, 5 motovedetat, (3,-65 foot dhe 2,-46 foot), kanë lënë gjurmët e tyre në çdo koordinatë të detit Adriatik dhe Jon. Ato janë anije të forta, me skaf metalik, sistem hidraulik

e elektrik të përsosur. Nuk gjen mjet më të mrekullueshëm. Dhe sot po ta kisha R-216, do mbretëroja me të, sa të ishte dynjaja, thotë Besniku. S'kam ngelur njëherë në mes të detit, kemi shpëtuar njerëz dhe me 9 ballë det. Por duhet të theksoj një fakt, gjatë viteve të para në i kemi riparuar këto anije së bashku me specialistët amerikanë. Nuk mund të harroj ndihmën e pakursyer të kolegut tim, Buci, i cili më dha njohuri e edukatë pune të përsosur, porosi të cilat i kam zbatuar gjithë kohës. Duke bërë riparim e mirmbajtje bashkë me teknikët amerikanë ne zgjeruam njohuritë tona, u bëmë motoristë të zotë. Kjo përvojë më ndihmoi të riparoj dhe motorin e Rimorkjatorit në vitin 2006, bashkë me kolegun tim Përparim Myftari dhe komandant Daniel Zenelin. Këtë e kam transmentuar dhe tek motoristët e anijes, gjithashtu dhe teknikët e oficinës, ku punova ca kohë. Ka disa vite që anijet tona kanë në përdorim motora "Caterpillar", të cilët janë teknologji bashkëkohore dhe duan specialistë të zotë. Sigurisht që për këto ka projekte dhe duhet ndihma e specialistëve amerikanë. Me sa kam dëgjuar ka një projekt të ODS për këtë. Theksoj se përsëri unë jam i gatshëm që të punoj me ta, në riparimin e këtyre anijeve, ashtu si me Motovedetën R-216. Me zor pres që të takoj kolegët dhe miqtë e mi të vjetër, zotin Buci, zotin Roy, etj. Riparimi i anijeve të shpejta "Archangel", dhe këto dhuratë e Departamentit të Shtetit të SHBA, do i shërbejë më së miri përgatitjes e trajnimit të një brezi të ri mekanikësh e motoristësh në Flotë.

Gjurmë në anije, gjurmë në bazë, gjurmë në jetë

Nuk janë vetëm aftësitë profesionale dhe dashuria për detin, karakteristikë e Besnikut. Ai është njeri i papërtuar dhe plot humor. Shpesh me shakatë e tij qetësonte ekipazhin e R-118, në lundrimet e vështira. I qeshur me të gjithë, i kudo ndodhur për çdo gjë në bazën e Pashalimanit, ai ka lenë gjumë gjithandej. Në vitin 2000, Besniku ngriti një mjedis bashkëkohor për shlodhjen dhe argëtimin e detarëve. Me ndihmën e dy djemve të tij emigrantë, Rikardit në Greqi dhe Aldrinit në Gjermani, ai ngriti një mjedis me lojëra elektronike, kalceto, bilardo, etj. ashtu si në kazemat e ushtrive të NATO-s. Makina e tij ka zgjidhur mjaft punë të repartit në ditët e vështira mbas 1997, tashmë palmat dhe lulet në bazë mbajnë vulën "Made in Besniku", madje ai i ka dhuruar repartit dhe një pompë uji dhe një autobus. Gjithashtu repartit dhe anijet kanë fituar nga komunikimi i thjeshtë i Besnikut me kolegët italianë. Duke përdorur shkathtësinë si dukatës, italianët kanë dhuruar materiale për anijet. Tashmë është në prag të pensionit dhe dëshiron t'i lerë bazës sa më shumë kujtime të mira. Vërtet 20 vjet në këtë bazë, por e kam jetuar dinamikën e saj me shpirt e zemër. E kam të vështirë të shkëputem prej saj. Dua ta mbyll me nder këtë punë, thotë Besniku, ta vizitoj me qef këtë bazë pas pensionit, pse jo të ndihmoj më të rinjtë gjatë difekteve. Motori është zemra e anijes, dhe më tepër duhet mëndje se sa forcë. Ai flet me respekt dhe për kolegët e tij të bazës së Kepit të Palit, mjeshtra e zanatlinj të mirë, si Arben Koci, Ylli Leka, Vahid Collaku, Eqerem Dervishi, Pëllumb Ruka, Hydri Collaku, Fatri Collaku, Ali Zhupani, Hamdi Ceka, Haki Stafa, Alfred Mara, A.Kojtari, etj. Puna dhe përkushtimi i Besnikut është pasqyruar dhe në shtypin ushtarak, ndërsa ka marrë falenderime nga eprorët e të gjitha niveleve në Flotë. Me mua janë sjellë mirë dhe më kanë vlerësuar punën të gjithë, thotë Besniku, ndaj flas me respekt për ta. Mendoj se Forca Detare dhe baza e Pashalimanit ka një brez të aftë e të arsimuar, që do e çojnë flotën tonë para, ashtu si vendet e tjera të NATO-s. Kam besim që nga komandanti Subi Zenelaj, zvëndësi Engjëll Sinanaj, shef Festim Derraj, kuadrot e tjerë Arif Curraj, Adrian Seraj, Altin Gaba, Ermal e Lace Hila, Ilir Cobo, Spartak Shyti, Eraldo Dautaj, Rigers Kordalli, Mario Miftari, Erald Haskocelaj, etj. ndaj i uroj atyre vetëm shëndet e suksese bashkë efektive e Flotiljes Detare Pashaliman. Mjeshtri ynë duarartë Besnik Berdo, po mbush 20 vjet në bazë, ai ka një jetë mes repartit dhe familjes. Kënaqem kur degjoj zhurmën e motorit "Detroit", ashtu si gjinkalla, por kënaqësia ime dyfishohet kur dëgjoj cicërimat e tëtë zogjve të mij, nga Gjeramia në Greqi, nga Orikumi në Tiranë, thotë Besniku. Ai tashmë është bërë tetë herë gjysh, ka plot shtatë nipa e një mbesë. Dy djemtë Rikardi dhe Aldrini dhe njëra nga vajzat Anila, janë emigrantë, ndërsa Esmeralda është pedagoge e anglishtes në Qendrën e Gjuhëve të Huaja në KDS, kjo është pasuria më e madhe e mjeshtrit Besnik Berdo bashkë me motorat e M/V R-216. Shpesh ai shkon në molin ku është bregëzuar anija e tij, R-216, bisedon me ekipazhin e saj më të ri, mediton dhe kujton lundrimet e miljet e pafund të kryera me të. Por, njëkohësisht, me vështrimin tek e ardhmja, Ai ka çfarë tu tregojë nipërve e mbesave të tij, rrugën e vështirë dhe të bukur të detarit! Mbase dikush do ketë fatin të bëhet detar, e mbyll rrëfimin mjeshtri Besnik Berdoj.

Në vend të një homazhi për atdhetarin, udhëheqësin ushtarak të talentuar, kontribuesin e çmuar dhe me vlera në krijimin e FA të Shqipërisë

NGA SALI ONUZI, KOLONEL (R)

Ali Shefqeti (Shkupi), i pari shef i Shtabit Madhor të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare

Në fund të prillit 1913 zbriste nga deti për në Vlorë një shqiptar 30 vjeçar, simpantik, me një ballë të lartë, me mustaqe spic. Tamam sikur të ish pritur vetëm ardhja e tij Qeveria e Përkohëshme e Vlorës do ta caktonte në detyrën e lartë të Kryetarit të Shtabit Madhor të Ushtrisë Kombëtare. Të një Shtabi që duhej edhe të drejtonte në luftë edhe të ngrinte Forcat e Armatosura, e sidomos ushtrinë e rregullt nga e para.

Ky 30 vjeçar ishte majori Ali Shefqeti (Shkupi), një personalitet të formuar, një patriot i njohur dhe një ushtarak i talentuar. Biri i një patrioti nga Peja, Hysen Shefqetit, dhe një shqiptareje nga një familje e pasur e Shkupit, Aliu u lind po në këtë qytet në shtator 1883. Kish mbaruar shkëlqyer shkollën qytetëse të Selanikut dhe gjimnazin ushtarak të Manastirit, ishte dalluar në Shkollën e Lartë Ushtarake (Harp Okulu) e pastaj në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Stamboll, të cilën e kishte përfunduar më 1905 së bashku me Mustafa Qemalin (Ataturkun). Në mbarim të Akademisë kish fituar gradën kapiteni i Shtatmadhorisë. Më pas kishte shërbyer në detyra të ndryshme në Armatën III në Maqedoni. I lidhur me lëvizjen xhonturke, kishte qenë në grupin e oficerëve që sulmuan më 1908, regjimin e vjetër absolutist sulltanor.

Shpejt Ali Shefqeti do të zhgënjehet nga xhonturqit dhe duke përfutur edhe nga detyra e tij në Selanik do të lidhej edhe më fort me rrethet atdhetare shqiptare. Në detyrën e komandantit të garnizonit të Stambollit, pas kryengritjes së përgjithëshme shqiptare të vitit 1912, major Ali Shefqeti u informua se qeveria osmane po përgatitej për ta arrestuar. Me përkrahjen e shqiptarëve të Stambollit u arratis në Rumani, prej nga shkoi në Trieste, ku në mars 1913 mori pjesë në Kongresin e Triestes me shumë atdhetarë të shquar të diasporës sonë.

Kishte dashur të vinte në Vlorë ku vepronte Qeveria e Ismail Qemalit Vlorës, por kishte qenë e pamundur ngaqë flota greke e mbante Vlorën të bllokuar. Në fund të prillit përfitoi nga një rast dhe zbriti nga një anije austro-hungareze në grykën e Semanit e prej aty në Vlorën e Pavarësisë dhe të entuziazmit të madh atdhetar.

Siç thashë më lart, më tu paraqitur, për shkak të njohjes dhe kredibilitetit që gëzonte, Ali Shefqeti do të ngarkohej me organizimin e Ministrisë së Luftës, gjë që, siç duket, e realizoi shumë shpejt: më 5 maj 1913 Qeveria e Përkohëshme e Vlorës do të diskutonte e miratonte Rregulloren për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës, në përbërje të të cilit do të ishte Shtati (Shtabi) Madhor. Major Ali Shefqeti do të emërohej menjëherë në detyrën e lartë e të nderuar të Kryetarit të këtij Shtabi. Ministria e Luftës do të kishte gjithashtu edhe zyrën Qertare (të prapavijës), zyrën hertare (të organizimit e personelit) dhe zyrën Shëndetare.

Në nyjen e dytë të kësaj Rregul-



”

Shtabi i drejtuar prej Ali Shefqet (Shkupi) i kish sugjeruar Qeverisë dhe ajo kishte porositur jashtë shtetit, sidomos në Austro-Hungari, topa, mitraloza, uniforma, dhe ajo që të befason më shumë, edhe “një numër librash shërbimi dhe veprash të ndryshme që do t’i shërbenin administratës ushtarake të Qeverisë”

loreje përcaktohej edhe ndërtimi i brendshëm i vetë Shtabit Madhor i cili, nga ana e tij, përbëhej nga qarqet (të themi drejtori, ose departamente), shkresina e tij, nga komisioni i rregulloreve, nga komisioni i trajtimit të policisë dhe të xhandarmërisë dhe nga komisioni i ndërtimit (ose ndoshta, si të thuash, të xhenjos). Rregullorja në mënyrë sintetike kish fiksuar edhe detyrat e të drejtat e tij. Në maj të vitit 1913 Shtabi Madhor kishte filluar nga detyrat e tij konkrete, të hartonte rregullore e të lëshonte urdhëra. Emri i Ali Shefqetit (Shkupit) të del gjithkund përpara në këto dokumente që ruhen në Arkivin e Shtetit.

Fakti që Ministria e Luftës e shtetit

”

Fakti që Ministria e Luftës e shtetit të ri shqiptar u konceptua dhe u ndërtua me Shtab Madhor, që më 1913, tregon se ndërtimi i Ushtrisë së rregullt filloi nga lart poshtë, karakteristike për një shtet ligjor, modern. Vetë ideja dhe ndërtimi i një Ushtrie me Shtab Madhor, ishin ideja dhe praktika europiane më e përparuar.

të Brendshme, Myfit Libohovës, variantin e parë të “Rregullores së Milicisë shqiptare”, para se të bisedohej në Këshillin e Ministrave.

Me detyrën e kryetarit të Shtabit Madhor, major Ali Shefqeti komunikonte me telegraf dhe transmetonte vendime të Qeverisë apo urdhëra e udhëzime të Ministrisë së Luftës e të vetë Shtabit për veprime luftarake në territore të ndryshme të vendit, në jug kundër forcave pushtuese greke dhe në Dibër ku po zhvillohej kryengritja e shtatorit të vitit 1913. Shtabi i drejtuar prej tij i kish sugjeruar Qeverisë dhe ajo kishte porositur jashtë shtetit, sidomos në Austro-Hungari, topa, mitraloza, uniforma, dhe ajo që të befason më shumë, edhe “një numër librash shërbimi dhe veprash të ndryshme që do t’i shërbenin administratës ushtarake të Qeverisë”. Në këtë punë Ali Shefqeti do të bashkëpunonte me sukses edhe me grupin e oficerëve holandezë që do të vinin në vendin tonë sipas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të 29 korrikut të vitit 1913, për organizimin e xhandarmërisë. Të kujtojmë se xhandari i vitit 1913 ishte edhe ruajtës i rendit edhe ushtar i luftës, një forcë ende e padiferencuar.

Që më 1913, nën udhëheqjen e Ali Shefqetit, Shtabi Madhor i pat hyrë një punë të veçantë për terminologjinë ushtarake. Për këtë çështje ai pat angazhuar një komision të posaçëm në të cilin bënin pjesë oficerë të kulturuar si Mustafa Maksuti dhe Kamber Sejdimi

(dëshmor i atdheut) nga Elbasani, ish profesor i frëngjishtes në gjimnazin ushtarak të Manastirit. Veprimtarisë së këtij komisioni i takojnë shumë terma që përdorim sot në fushën ushtarake. Kjo veprimtari është një tregues tjetër i kulturës së Shtabit Madhor, dhe kryetarit të tij, Ali Shefqetit, që në kushte aq të rënda, të një shteti të ri, që luftonte për ekzistencë me armë e diplomaci, ditën të çmojnë vlerën e kulturës ushtarake si pjesë të luftës për liri dhe pavarësi.

Major Ali Shefqeti, edhe pas dorëheqjes së Qeverisë së Ismail bej Vlorës më 22 janar 1914, ka mbajtur e ushtruar poste të larta drejtuese në Ushtrinë tonë Kombëtare. Me fillimin e Luftës së Parë Botërore, Ali Shefqeti u arrestua nga forcat malzeze në qytetin e Shkodrës dhe u burgos deri në vitin 1916 kur trupat austro-hungareze hynë në Malin e Zi. Përkrahës aktiv i Kongresit të Lushnjës, Qeveria e dalë prej tij (janar 1920) do ta caktonte nënkolonel Ali Shefqetin së pari komandant të Komandës së Përgjithëshme, e më pas, me krijimin e Ministrisë së Luftës përsëri në detyrën e Shefit të Shtabit Madhor. Patriot e demokrat, i lidhur ngushtë me Hasan Prishtinën, Aliu do të ishte nga më aktivët në Lëvizjen e Qershorit të vitit 1924 dhe do të ngarkohej përsëri me detyra të larta në krye të Ushtrisë Kombëtare.

Pas dy internimesh dhe largimit nga ushtria regjimi monarkist e dënoi Ali Shefqetin me vdekje si nisiatori dhe kryetari i Organizatës së fshehtë për rrëzimin e Zogut me kryengritje të armatosur në vitin 1935. Pas protestave të fuqishme nga brenda dhe jashtë, regjimi nuk guxoi ta ekzekutonte dhe Ali Shefqeti doli nga burgu në vitin 1938.

Ali Shefqeti dënoi dhe kundërshtoi pushtimin fashist të atdheut. Nazistët gjermanë i dogjën shtëpinë në Tiranë. Më pas familjarisht u vendos me banim në Shkodër, ku jetoi me një pension prej tremijë lekësh. Vdiq më 3 dhjetor të vitit 1953 dhe u varros në Shkodër. Në vitet tetëdhjetë ai u rivarros në Tiranë. Në vitin 1992, Ali Shefqeti (Shkupi) u dekorua me urdhërin “Për veprimtari patriotike të klasit të Parë”.

Ky shkrim modest është një homazh për atdhetarin e flaktë, për udhëheqësin ushtarak të talentuar, kontribuesin e çmuar dhe me vlera në krijimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

KAPITEN ERVIN HODO

Afganistani, e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja

Talibanët janë një grup terrorist islamik suni, i cili qeverrasi Afganistanin në vitet 1996-2001, derisa një sulm i udhëhequr nga SHBA, largoi regjimin, i cili i jepte strehë grupeve terroriste të Al-Qaeda dhe liderit të tyre Osama bin Laden. Edhe pse kanë rënë nga pushteti, prej më shumë se një dekadë, Talibanët, qëndrojnë të duruar dhe të qetë në rajon, duke krijuar dhe operuar me struktura paralele të qeverrisjes, të cilat kanë për synim të sabotojnë qeverrisjen qendrore të krijuar nga SHBA. Ndërkohë që mbështetja e Pakistanit dhe “qiejtë e sigurtë” për Talibanët, kanë bllokuar përpjekjet ndërkombëtare, për t'i dhënë fund konfliktit. Që prej vitit 2010, SHBA dhe zyrtarët afganë, kanë arritur të bindin grupet rebele, të fillojnë negociatat, por me tërheqjen e planifikuar të forcave të NATO-s në fund të 2014, shumë analistë thonë se prosperiteti i një marrëveshjeje të tillë, ngelet i zbehtë.

Ngritja e Talibanëve

Talibanët u formuan nga muxhaidinët afganë, të cilët luftuan kundër pushtimit Sovjetik, në vitin 1980 dhe nga tribuja a Pashtunëve, të cilët kishin studiuar në shkollat fetare (medresetë) e Pakistanit, si dhe në sajë të asistencës nga Shërbimi Sekret i Pakistanit. Talibanët (fjalë e dialektit Pashtu për “studentët”), u zhvilluan si forcë kombëtare politike, në vitin 1994 në mesin e luftës civile, që kishte përfshirë vendin. Pas një seri fitoresh dhe kapjeve terroresh, ata kapën kryeqytetin Kabul, në Shtatorin e vitit 1996, duke larguar qeverrinë e Burhanuddin Rabbani. Përpara se të binin nga pushteti, pas sulmit të forcave amerikane në Nëntor 2001, analistët thonë se Talibanët kontrollonin rreth 90% të vendit.


Duke qënë në fuqi për pesë vjetësh të ashpër, Talibanët aplikuan një formë të egër të ligjit islamik, duke kërkuar që femrat të mbuloheshin me vel nga koka deri te këmbët, duke ndaluar muzikën dhe televizionin, burgosën meshkujt, të cilët e prisnin mjekërrën shumë shkurt. Ministria e frikshme e Promovimit të Vlerave dhe Ndalimit të Veseve, përforcoi ndalesat për sjelljet që dobësonin modelin e islamit. Shumë analistë, thonë se shkatërrimi i statujës kolosale të Budës, në Bamianin në vitin 2001, ishte një tregues i intolerancës së regjimit.

Kundërshtimi, atëherë dhe tani

Talibanët, ishin izoluar shumë kohë më parë se të ndodhnin sulmet e 11 Shtatorit, duke pasur parasysh që vetëm Pakistani, Arabia Sauditë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, e njohën regjimin ekstremist, në Kabul. Pakistani, do të mbështeste Talibanët, duke u bazuar tek kërkesa e tij për “thellësi strategjike” në Afganistan, në mënyrë që të fitonte pozita dominuese mbi Indinë, rivalen e tij të përhershëm.

Por, fuqitë botërore lëvizën menjëherë për të censuruar qeverrinë Talibanë, jo shumë kohë pas ardhjes së saj në fuqi. Një numër rezolutash të Këshillit të Sigurisë, së OKB, në 1998 i kërkonin Talibanëve t'i jepnin fund trajtimit abuziv të grave, dhe në vitin 1999 blloku vendosi sanksione kundër regjimit për strehimin që ata i ofruan Al-Qaeda-s. (Këto sanksione u përditësuan periodikisht. Në mënyrë që të lehtësonin negociatat, sanksionet u ndanë në vitin 2011, kjo për të bërë dallimin midis Talibanëve dhe Al-Qaeda dhe atyre që e mbështesnin).

Në vitet 1990, grupe të ndryshme në Afganistanin verior, kundërshtuan regjimin Taliban, duke përfshirë këtu edhe ish-presidentin Rabbani, duke formuar kështu Aleancën e Veriut. Me dominim Takhik, por edhe me enticite të tjera si Uzbek dhe Shiit Hazara, Aleanca ndihmoi forcat amerikane kundër Talibanëve, pas sulmeve të Shtatori 2011. Disa analistë, thonë se frika që kanë Talibanët për tu përballur me një Aleancë të Veriut të fuqizuar, në prag të tërheqjes së amerikaneve dhe të NATO-s në vitin 2014, është një faktor që do t'i drejtojë ata, në negociatat të mundshme.



Leadershipi dhe Struktura Mbështetëse

Mullah Mohammed Omar, një klerik islamik dhe lider ushtarak, i cili humbi syrin e djathtë duke luftuar sovjetikët, drejtoi Afganistanin nga viti 1996 deri në vitin 2001 si “komandanti besnik”. Filimisht, Omari i dha strehim al-Qaeda me kushtin e mos kundërshtimit direkt të Shteteve të Bashkuara. Megjithatë bin Laden, iu rebelua kësaj marrëveshjeje, duke orkestruar sulmin në bombë, mbi ambasadën e SHBA në Afrikën e Lindjes në vitin 1988, një episod për të cilin analistët thonë se ishte një tregues i tensionit midis dy grupeve, përpara ngjarjeve të 11 Shtatorit. Megjithatë, duke besuar ende se kërcënimin i SHBA për sulm ishte i pabesueshëm, Omari nuk hoqi dorë nga bin Laden pas sulmeve. I raportuar shpesh si i vendosur në Pakistan, Omari dhe shumë nga këshilltarët e tij kryesore, vazhdojnë të drejtojnë leadershipin qendror Taliban, të njohur si Quetta Shura Taliban (QST), emër që e morën sipas qytetit, ku u strehuan pas sulmit të SHBA-ve. Zëvendës komandanti i grupit, Mullah Abdul Ghani Baradar, u kap gjatë operacionit amerikan-pakistanez në Karaci në vitin 2010. Disa ushtarakë analistë llogarisin se janë afërsisht rreth 25.000 rebelë afganë, me nivele të ndryshme lidhje me Talibanët, por vlerësimet për fuqinë e këtyre grupeve variojnë. Një partner strategjik i Talibanëve, ngelet Rrjeti Hakani (Haqqani Network) një grup terrorist, operacionet e të cilit përfshirë këtu edhe sulmet ndaj trupave të NATO-s, shtrihen përgjatë vijës Durand, kufiri që ndan Afganistanin me Pakistanin, duke vazhduar përmes zonave të fiseve Pashtun dhe Balok. Themeluesi i grupit, Jalaluddin Haqqani, kishte lidhje me bin Laden në mes të viteve 1980 dhe iu bashkua Talibanëve në vitin 1995, kjo sipas Departamentit Amerikan të Shtetit.

“Rrjeti Hakani ka qenë më i rëndësishëm se çdo grup tjetër, për mbështetjen dhe zhvillimin e al-Qaeda dhe xhihadit global”, thuhet në një raport të Qendrës së Luftës Kundër Terrorizmit në West Point, në vitin 2011. Numërohen rreth tre mijë luftëtarë dhe mbështetës të Hakanit. Ndërkohë që shumë ekspertë dyshojnë se shërbimi sekret pakistanez, vazhdon t'i mbështesë Talibanët edhe pse Islamabadi i ka mohur gjithmonë këto deklarata. (Talebantët e Pakistanit, ndryshojnë në mënyrën organizative, nga grupi afgan i ngritur në vitin 2002, në kundërpërgjigje të inkursionit të ndërmarrë nga ushtria e Pakistanit, në zonat e tribuve për të goditur militantët.)

Megjithatë ndërhyrjen fillestare nga Mullah Omari, prodhimi dhe trafikimi i

opiumit, kanë financuar rimëkëmbjen e Talibanëve, duke iu siguruar atyre rreth 200 milion dollarë çdo vit, kjo sipas zyrës së KB për Drogën dhe Krimin. Afganistani, është në krye të prodhuesve botërorë të opiumit, duke numëruar rreth 75% të prodhimit global, të furnizimit me heroinë në vitin 2012.

Opinionin publik për Talibanët

Reagimi publik, ndaj regjimit Taliban, nuk ishte tërësisht negativ, ose të paktën ishte kështu në fillim. Me anë të standarteve të ashpra sociale, Talibanët rrëzuan korrupsionin i cili kishte përfshirë vendin para ardhjes së tyre në pushtet. Regjimi i tyre, solli gjithashtu një stabilitet relativ në Afganistan, duke reduktuar luftën midis zotërve të luftës, e cila kishte shkatërruar popullsinë civile, gjatë pushtimit sovjetik dhe luftën civile që e pasoi.

Pas më tepër, se një dekadë nga rënia e tyre nga pushteti, Talibanët vazhdojnë të gëzojnë mbështetje, edhe pse jo shumë të fortë. Një fondacion Aziatik, gjeti se në fund të vitit 2012, rreth 30% e afganëve

tek policia lokale afgane, shënonte shifrën e 39%, sistemi i drejtësisë 50% dhe ministrit e qeverisë 55%. Rebelimi, ka një mbështetje më të madhe, sidomos në zonat ku fitoret ushtarake, nuk janë kombinuar me programet dhe reformat qeveritare për zhvillim.

Një rebelim i heshtur

Administrata e Presidentit Obama, ende pa u mbyllur mirë plagët e luftës në Irak, riangazhoi operacionet kundër rebelimit në Afganistan. Në dhjetor 2009, duke iu adresuar me një fjalim kadetëve të West Point, presidenti shpalli një shtim trupash prej 30.000 vetash, të cilët do t'i bashkoheshin 68.000 trupave, që ishin tashmë të dislokuara, gjithashtu ai dyfishoi mbështetjen me civilë (kryesisht kontraktorë) si dhe iu kushtua shumë rëndësi diplomacisë me Pakistanin.

Megjithatë, rebelët vazhuan të shtonin sulmet në 2013, ndërsa Pentagoni reduktoi numrin e trupave në terren, përfshirë edhe autoritetin e drejtimit duke ua dorëzuar forcave afgane në Qershor. Kombet e Bashkuara, numëruan rreth



kishin simpati për grupet anti-qeveritare, një numër i cili kishte qenë më i ulët përgjatë katër viteve të mëparshme. Vëzhgimi i Fondit Aziatik, vuri re se në vitin 2012 30% e afganëve, kishin simpati për grupet antiqeveritare, një figurë që kishte rënë katër vitet e shkuara. Ndërkohë, që rreth 81% e afganëve të vëzhguar, favorizonin mbështetjen e qeverrisë në negociatat me rebelët e armatosur, numër ky i cili ka ngelur pothuajse i pandryshuar që nga viti 2009.

Mbështetja që gjejnë rebelët nga popullsia afgane, vjen kryesisht për shkak të humbjes së besimit të popullit, tek institucionet publike. Ndërkohë që Fondi Aziatik, nga vëzhgimi i bërë, gjeti se besimi për Ushtrinë Kombëtare Afgane dhe Policinë Kombëtare Afgane, rezultonte përkatësisht në shifrat 93 dhe 82%. Ndërkohë që besimi që ata kishin

katër mijë viktime civile, në gjysmën e parë të 2013, një rritje me 23% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sulmet vetevrasëse, një taktikë e padëgjuar para vitit 2001 për Afganistanin, kanë ngelur konstante që në vitin 2009, me një mesatare prej 150 për vit. Ndërkohë, Talibanët shtuan sulmet “green-on-green” dhe “green-on-blue”, në të cilat Talibanët infiltrohen në policinë dhe ushtrinë afgane dhe kthejnë armët e tyre kundër policëve, apo ushtarakëve afganë, ose kundër forcave të NATO-s. Kjo regjistroi 15% të vdekjeve të trupave të NATO-s, në vitin 2012, çka përbënte më shumë sesa dyfishin e një viti më parë.

Veprimet amerikane dhe arrestimet e kryera nga Pakistani, kanë shtuar presionin mbi Mullah Omarin, por, ekspertët thonë se Talibanët janë duke fituar kohë, duke besuar se pas largimit

të forcave të NATO-s edhe nëse nuk do arrijnë të krijojnë një monopol fuqie për të kontrolluar gjithë vendin, të paktën do krijojnë një pikëmbështetje të fortë dhe të qëndrueshme në Jug dhe në Lindje.

E ardhmja e rebelëve, varet në një fare mase nga natyra e përfshirjes së ushtrisë amerikane, pas tërheqjes së vitit 2014, e cila me shumë gjasa do të kërkojë një personel të madh dhe të devotshëm për të trajnuar forcat afgane për të zhvilluar operacione kundërterrorizmit. Ka shumë gjasa që Pentagoni do t'i jap fund operacioneve kundër menjëherë sapo tërheqja e tyre të ketë përfunduar, por nga ana tjetër grupet rebele po rishpallin dhe po bëjnë thirrje për terrorizëm ndërkombëtar.

Disa analistë, e shikojnë tërheqjen e plotë të Pentagonit nga Iraku në vitin 2011, si pasojë e dështimit për të arritur një marrëveshje bilaterale sigurie, midis Uashingtonit dhe Bagdadit. Në vitin 2013, dhuna sektare arriti nivele që nuk ishin parë që në vitin 2008 dhe al-Qaeda pati një fitore momentale. Një vakum sigurie, në të cilin grupe si al-Qaeda gjejnë terren të përshtatshëm, do të kërcënojnë interesat e ngjashme amerikane dhe afgane.

Megjithatë, zyrtarët amerikanë synojnë t'i rrëzojnë këto shqetësime. Ndryshe nga Iraku “afganët në fakt, kanë nevojë për ne që të qëndrojmë... shumë afganë duan që ne të qëndrojmë. Dhe ne kemi premtuar të qëndrojmë”, i tha përfaqësuesi special amerikan në Afganistan dhe Pakistan James Dobbins Senatit në Korrik.

Një fundloje e paqartë për Afganistanin

Që prej vitit 2010, strategjia e fundit të lojës e Washingtonit, ka përfshirë një marrëveshje negociimi me Talibanët, duke shtuar bindjen se grupet rebele, nuk mund të shtypen vetëm me forcë, sidomos kur vazhdojnë të kenë mbështetjen e pandërprerë të Pakistanit. Nga ana tjetër, Talibanët janë të lodhur nga lufta dhe duket se janë të etur për të fitar pavarësi nga Pakistani dhe të rrisin influencën në Afganistan.

Sipas Shërbimit për Kërkime të Kongresit, Mullah Omari rrethohet nga pragmatistët të cilët “fajësojnë shoqërimin me al-Qaeda në të shkuarën, si shkak të humbjes së pushtetit të tyre” dhe janë të hapur për të bërë kompromis me Perëndimin, duke bërë llogari që legjitimiteti ndërkombëtar, është i nevojshëm për mbijetesën e tyre në terma afatgjata. Por, shumë të tjerë ngelen të lidhur me ideologjinë e debimit të të huajve dhe rimarrjen e pushtetit menjëherë pas largimit të NATO-s. Kundërshtarët e Omarit, në tavolinën e bisedimeve, shtatëdhjetë anëtarët e Këshillit të Lartë Afgan për Paqen, të themeluar në Kabul në vitin 2010, për të sjellë paqen, insistojnë që Talebantët të ndalojnë rebelimet, të çarmatosen dhe të pranojnë kushtetutën afgane, të cilën Talibanët e shikojnë si të imponuar nga të huajt.

Bisedimet kanë shënuar një numër të madh kthimesh mbrrapa, qysh në kohën e fillimit të tyre të konfirmuar në Korrik 2011. Në shtator të po atij viti, shefi i bisedimeve për paqe në Kabul ish-presidenti Rabbani u vra. Ndërkohë “potenciali për kthim mbrrapa” në lidhje me të drejtat e njeriut, sidomos përsa iu takon të drejtave të grave, ka ngritur shumë kundërshti nga shoqëria civile, pavarësisht moderimit gradual të Talibanëve në lidhje me çështjet sociale. Në qershor 2013, lojalistët e Mullah Omarit, hapën një zyrë politike në Doha, për të lehtësuar bisedimet. Skeptikët, thonë se zyra në fakt është një pikëqëndrimi i qeverisë në ekzil e themeluar nga Talibanët, në mënyrë që të fitojnë legjitimitet ndërkombëtar, si dhe të zhvillojnë çështje diplomatike.

Gushti i 2013, solli disa shenja shprehe për procesin e paqes, kur u zbulua se qeverria afgane dhe liderat Talibanë, kishin zhvilluar bisedime paraprake jo zyrtare. Megjithatë, Mullah Omari shpalli se grupet rebele do t'i bojkotonin zgjedhjet e 2014 dhe do të vazhdonin luftën e tyre, derisa trupat e huaja të largoheshin...

Bëhu dhe ti pjesë e Forcave të Armatosura!



NJOFTIM

Kriteret e përgjithshme për rekrutimin e Ushtarëve /Detarëve Aktiv

- a). Për t'u rekrutuar në Forcat e Armatosura si ushtar/detar aktiv shtetasit shqiptarë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
- Të jetë shtetas shqiptar.
 - Të mos jetë dënua nga gjykata për vepra penale.
 - Të mos jetë në ndjekje penale.
 - Të mos ketë humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit ose veprimtarisë në administratën publike me vendim gjykate.
 - Të mos jetë në proces gjykimi penal nga Gjykata
 - Moshë minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtar/detar aktiv, nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përgjithësisht bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç
 - Të ketë kryer arsimin parauniversitar ose të lartë brenda ose jashtë vendit.
 - Të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtar/detar aktiv nga Spitali Ushtarak i Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse.
 - Të ketë kaluar testin, fizik, intelektual dhe psikologjik.
 - Kandidatët për ushtar/detar aktiv të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat.
 - Kandidatët për ushtar aktiv, të planifikuar për kompletimin e Policisë Ushtarake, duhet të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt dhe femrat.
- b). Për rekrutimin sipas specialiteteve të veçanta, veç këtyre kriterëve të aplikohen edhe kritere Specifike për aftësitë profesionale dhe parametrot fizikë, të cilat përcaktohen me një udhëzim të veçantë të SHSHP.

Procedura e aplikimit për Ushtar/Detar Aktiv.

- a) Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtar/detar aktiv, do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit.
- b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit dhe pranimit të dokumentacionit (bashkëlidhur këtij udhëzimi) dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimit e përzgjedhjes.
- c) Procedurat, kriteret, rregullat e testimit bëhen publike në faqen e internetit të Forcave të Armatosura.

Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm

- a) Kandidatët për ushtar/detar aktiv, paraqesin në Qendrën e Personel Rekrutimit, dokumentet e mëposhtme:
- Kërkesë me shkrim, në të cilën parashtrohet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyt për të cilat dëshirojnë të bëhet ushtar/detar aktiv, njësia apo reparti në të cilin do të dëshirojnë të shërbyer. Aftësitë, përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi (formulari i aplikimit).
 - Fotokopjen e kartës së identitetit
 - Certifikatë familjare.
 - Dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm
 - Fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar ose të arsimit të lartë të noterizuar dhe të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale/Rrethit.
 - Diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), të noterizuar.
 - Dëshmi penaliteti.
 - Vërtetim nga prokuraria.
 - Vërtetim nga gjykata.
 - Fletë të ekzaminimit mjekësor nga Spitali Ushtarak i Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse.



Aplikoni në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit.
www.mbrojtja.gov.al www.aaf.mil.al